



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 575 Akti

Nr. 648 Vendimi  
Tiranë, më 19.4.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Xhensila Pine</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Suana Stafa, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, në datën 14.4.2023, ora 10.00 dhe Steven Kessler, në datën 19.4.2023, ora 12:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Sokol Nishani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Sokol Nishani, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Sokol Nishani ushtron detyrën e prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.6.2020 dhe do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli (kryesuese), Xhensila Pine (anëtare) dhe Olsi Komici (relator), ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Ferdinando Buatier De Mongeot.
- 3.** Me vendimin e datës 22.6.2020, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Sokol Nishani për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe rivlerësimin e aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike<sup>1</sup>, ku iu komunikua përbërja e trupit gjyqësor dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit nëse do të kishte me ndonjë nga anëtarët e trupit.
- 4.** Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard nuk deklaroi të kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjyqësor.
- 5.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
- 6.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

---

<sup>1</sup> Subjekti u njoftua në datën 2.7.2020 me anë të postës elektronike.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani, si dhe njoftimin e tij për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 23.3.2023<sup>2</sup> mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 6.4.2023. Subjekti i rivlerësimit brenda afatit të lënë nga Komisioni ka depozituar pranë zyrës së protokollit shpjegimet dhe provat përkatëse.

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në datën 7.4.2023 në seancën dëgjimore, e cila do të zhvillohej më 14.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0, Tiranë.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 14.4.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e tij dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

11. Z. Sokol Nishani ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

13. Për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

14. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II

---

<sup>2</sup> Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë me rrugë elektronike.

të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**15.** ILDKPKI-ja<sup>3</sup>, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Sokol Nishani, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucioni që prej vitit 2003, me nr. indeksi \*\*\*, dhe në përfundim të veprimeve verifikuese ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**15.1** Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njoftohen rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

### **❖ Mbi asetet e deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting***

#### ***Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit***

**1. Pasuria zyrë pune, me sip. 40m<sup>2</sup>**, e ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës, e blerë me kontratën e shitblerjes datë 31.1.2013<sup>4</sup>, me vlerë 70,000 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten. Burimi i krijimit: (a) 30,000 euro kontratë huaje, datë 29.1.2013<sup>5</sup>; (b) 30,000 euro kredi në “Raiffeisen Bank”, marrë në datën 24.1.2013; (c) 10,000 euro kursime familjare.

#### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.1** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2013 (në vijim DIPP).

**1.2** Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkë me deklaratën *Vetting* rezulton se njësia me sip. 40 m<sup>2</sup> është përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 31.1.2013, me palë shitëse H. e Z. D. dhe palë blerëse E. dhe Sokol Nishani, për çmimin 70,000 euro, e shoqëruar me certifikatën për vërtetim pronësie të lëshuar nga ish-ZVRPP Durrës në datën 18.2.2013 në emër të shtetasve E. dhe Sokol Nishani.

<sup>3</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2020, i ILDKPKI-së.

<sup>4</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* datë 31.1.2013, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

<sup>5</sup> Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 29.1.2013.

**1.3** Gjatë hetimit subjekti i rivlerësimit ka depozituar mandatpagesën e lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare (në vijim BKT), ku rezulton se në datën 30.1.2013 z. Sokol Nishani ka derdhur *cash* në llogari të shitësit H. D. shumën 70,000 euro, për blerje dyqani.

**1.4** Agjencia Shtetërore e Kadastrës Durrës<sup>6</sup> (në vijim ASHK) konfirmon pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit “njësi”, e cila ka qenë në pronësi të shtetasit H. D. dhe me kontratën e shitjes së lartpërmendur u ka kaluar pronësia shtetasve Sokol e E. Nishani. Edhe nga ana e Furnizuesit të Shërbimit Universal (në vijim FSHU)<sup>7</sup> konfirmohet kontratë furnizimi me energji elektrike me datë hapjeje 19.8.2013, të lidhur me abonentin E. N..

**1.5** Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së njësisë, ku nga dokumentacioni i përcjellë nga ASHK Durrës konstatohet se ky çmim prej 70,000 euro është llogaritur i konvertuar në vlerën 9,770,600 lekë, kurse çmimi i njësisë për efekt të pagesës së taksës mbi kalimin e pronësisë është llogaritur në vlerën e rivlerësuar në datën 13.8.2012 prej 4,485,554 lekësh. Marrë shkas nga fakti se çmimi i blerjes së njësisë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij është shumë më i madh se ai i rivlerësuar nga ana e shitësit, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie.

**1.6** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>8</sup>, e cila konfirmon se për shtetasin H. B. D. janë regjistruar dy materiale hetimore: (a) materiali hetimor nr. \*\*\*, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit; dhe (b) materiali hetimor nr. \*\*\*, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit në datën 16.4.2018.

**1.6.1** Materiali hetimor nr. \*\*\* është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili, me vendimin e datës 30.7.2014, ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal mbi kallëzimin nr. \*\*\*” për kallëzimin e referuar në ngarkim të shtetasit H. D. për veprën penale ‘dhunë në familje’*”.

**1.6.2** Komisioni vëren se, për sa kohë nuk duket se subjekti dhe personi i lidhur me të të ketë përfituar njësinë zyrë me ndonjë çmim preferencial dhe në kushtet kur çështja penale është hetuar nga subjekti pasi ka përfunduar marrëdhënia e interesit pasuror dhe nuk ka vijuar në të ardhmen, marrë për bazë edhe praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>9</sup>, vlerësohet se subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 70,000 euro, me të cilën është blerë zyra me sip. 40 m<sup>2</sup>, si vijon:**

**1.7 Burimi I – shuma 30,000 euro** marrë shtetasit R. C. me kontratën e huas datë 29.1.2013. Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja E. N., në deklaratën *Vetting* ka deklaruar huan e marrë në shumën 30,000 euro, në datën 29.1.2013, nga xhaxhai i saj R. C., me qëllim blerje zyre. Të njëjtin deklaram për huan ka bërë edhe në DIPP-në e vitit 2016. Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2017 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar *shlyer një pjesë e huas prej 7,000 euro xhaxhait,*

<sup>6</sup> ASHK Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021.

<sup>7</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021, e FSHU-së konfirmon kontratën e furnizimit nr. \*\*\*.

<sup>8</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>9</sup> Vendimi nr. 8 (JR), datë 7.4.2022, i subjektit të rivlerësimit E. H.

me kontratën nr. \*\*\*, datë 29.12.2017. Në DIPP-në e vitit 2018 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar shlyerje të huas.

**1.7.1** Subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar kontratën e huas datë 29.1.2013<sup>10</sup>, me huadhënës R. C. dhe huamarrës E. N., për dhënien hua të shumës 30,000 euro. Në kontratë deklarohet se kjo vlerë monetare jepet pa interes dhe kthimi i huas nga huamarrësi do të bëhet brenda një periudhe 5-vjeçare nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, brenda datës 29.1.2018.

**1.7.2** Në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se shuma 30,000 euro, dhënë hua bashkëshortes nga xhaxhai i saj, është siguruar dhe disponuar nga ky i fundit për shkak se disa muaj më parë, në datën 6.9.2012, i ka shitur shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. pasurinë truell me sip. 517 m<sup>2</sup>, brenda së cilës ndodhet një godinë me sip. 92 m<sup>2</sup>, pasuri kjo e ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës, për çmimin 68,500,000 lekë, likuiduar *cash*, sipas kontratës së shitblerjes datë 6.9.2012<sup>11</sup>, të cilën subjekti e ka depozituar në cilësinë e provës. Gjithashtu, Komisioni ka verifikuar në sistemin elektronik të ASHK-së në lidhje me këtë transaksion dhe ka rezultuar se është bërë kalimi i pronësisë së kësaj pasurie në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

**1.7.3** Komisioni ka administruar përgjigjen e ASHK Drejtoria Durrës<sup>12</sup>, e cila konfirmon se nuk rezulton që shtetasi R. C. të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme dhe nuk figuron aplikues në procesin e legalizimit. Po kështu, edhe nga përgjigjet e administruara nga drejtoritë e ASHK-së Tiranë<sup>13</sup> nuk rezulton praktikë legalizimi në emër të shtetasit R. C., si dhe nuk figurojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme në emër të tij.

**1.8 Burimi II – shuma 30,000 euro**, kredi në “Raiffeisen Bank”, datë 24.1.2013. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe në deklaratën *Vetting* kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” dhe për të provuar këtë marrëdhënie ka depozituar kontratën e kredisë datë 24.1.2013<sup>14</sup>, me kredihënës “Raiffeisen Bank” dhe kredimarrës Sokol e E. Nishani, për shumën 30,000 euro, me qëllim përdorimi “konsumatorë me hipotekë”. Në nenin 6 të kontratës është parashikuar sigurimi i kredisë, duke vënë hipotekë mbi pasurinë apartament me sip. 146.46 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, z. k. \*\*\*, Durrës.

**1.8.1** “Raiffeisen Bank”<sup>15</sup> konfirmon kredinë e marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në datën 28.1.2013, në shumën 30,000 euro, si dhe mbylljen e saj më 20.5.2014. Në datën 12.5.2014 subjekti i rivlerësimit dhe E. N., në cilësinë e personit fizik, kanë lidhur kontratë kredie bankare<sup>16</sup> për shumën 28,325 euro, me qëllim mbylljen e detyrimit për kredinë hipotekore në llogarinë e kredimarrësit Sokol Nishani pranë “Raiffeisen Bank”.

<sup>10</sup> Kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 29.1.2013.

<sup>11</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 6.9.2012.

<sup>12</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2023, e ASHK Durrës.

<sup>13</sup> Përgjigje: nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2023, e Njësisë së Kadastrës dhe Hartografisë; nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2023, e Drejtorisë Vendore Tirana Jug; nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023, e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2; nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2023, e Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 1.

<sup>14</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\*, datë 21.1.2013.

<sup>15</sup> Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2023, të “Raiffeisen Bank”.

<sup>16</sup> Kontrata e kredisë nr. \*\*\*, datë 12.5.2014 dhe kontrata e hipotekës nr. \*\*\*, datë 12.5.2014.

**1.8.2** Komisioni konstaton se subjekti nuk e ka deklaruar këtë kredi në DIPP-në e vitit 2014 si një kredi të re të marrë për mbylljen e kredisë së vjetër, por ka vazhduar deklarin për kredinë e marrë në vitin 2013 dhe me pyetësin nr. 2 i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mosdeklarimin e kësaj kredie në DIPP-të e viteve 2014 – 2016 dhe në deklaratën *Vetting*. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se kjo kredi prej 30,000 euro është marrë për plotësimin e shumës 70,000 euro, me qëllim blerje të zyrës noteriale. Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë burim.

**1.9 Burimi III – shuma 10,000 euro kursime familjare.** Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin standard në lidhje me shumën 10,000 euro, ka deklaruar se është siguruar nga kursimet familjare të cilat kanë qenë të mbyllura në depozitë bankare tek “Intesa Sanpaolo Bank” (në vijim ISP Bank) në Durrës që nga data 8.1.2009 dhe janë tërhequr në datën 14.1.2013. Subjekti ka depozituar mandatin datë 14.1.2013, të lëshuar nga ISP Bank, ku rezultoi se shtetasja E. N. ka tërhequr shumën 1,268,853 lekë, me përshkrimin “për blerje zyre”.

**1.9.1** Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të vitit 2008 (në vijim DPDFD), subjekti ka deklaruar: *“Llogari rrjedhëse pranë ‘Intesa Sanpaolo Bank’, Durrës, në shumën 1,000,000 lekë. Shitja e banesës 1+1 në L. \*\*\*, Durrës”*. Në DIPP-në e vitit 2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar si një nga burimet e shumës 70,000 euro edhe tërheqjen e depozitës prej 1,268,853 lekësh, në datën 14.1.2013 (është depozita e krijuar nga shuma 1,000,000 lekë nga shitja e shtëpisë 1+1, L. \*\*\*, Durrës).

**1.9.2** Komisioni, me pyetësin nr. 2, i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me mospërputhjet në deklarim për destinacionin e shumës 1,000,000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit 1+1, pasi ka deklaruar ndër vite se kjo shumë është përdorur për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2006, në shumën 550,000 lekë ashtu edhe për blerjen e automjetit tip “KIA” në vitin 2008, në shumën 750,000 lekë, si dhe për depozitim në ISP Bank në vitin 2008, në shumën 1,000,000 lekë.

**1.9.2.1** Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se në datën 8.1.2009 ai dhe bashkëshortja kanë depozituar në ISP Bank shumën 1,010,000 lekë, të përfituar nga shitja e apartamentit me sip. 50.85 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës. Kjo shumë ka qëndruar e depozituar në bankë deri më 14.1.2013 dhe për shkak të interesit bankar ka shkuar në shumën 1,268,853 lekë, e cila është tërhequr dhe përdorur për blerje të zyrës noteriale për të plotësuar shumën 70,000 euro.

**1.9.3** ISP Bank<sup>17</sup> konfirmon se në datën 4.9.2008 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 1,000,000 lekë dhe në datën 8.1.2009 e ka kaluar këtë shumë në depozitë bankare, e cila në datën 14.1.2013, kur është tërhequr përfundimisht, ka arritur vlerën 1,268,853 lekë.

**1.9.4** Komisioni kreu analizën financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit për të mbajtur të kursyer shumën 1,000,000 lekë, të përfituar nga shitja e apartamentit nga data 28.3.2002 kur është shitur apartamenti deri në datën 4.9.2008 kur është depozituar në bankë, shumë kjo që pas hapjes së depozitës është tërhequr në datën 14.1.2013 dhe është përdorur për blerjen e dyqanit. Në këtë analizë paraprake, Komisioni mori në konsideratë deklaratat periodike të viteve 2003 - 2004,

---

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021.

deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës së tij si oficer i policisë gjyqësore (në vijim OPGJ)<sup>18</sup>.

**1.9.5** Gjatë hetimit administrativ Komisioni konstatoi se: (i) subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e dyqanit në shumën 10,000 euro, pasi nuk u provua ligjshmëria e kursimeve familjare prej 10,000 euro; dhe (ii) subjekti i rivlerësimit të shpjegojë arsyet e mosshlyerjes së huas prej 30,000 euro brenda afatit 5-vjeçar të përcaktuar në kontratën e huas. Për këto konstatime subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**1.9.6** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e dyqanit në shumën 10,000 euro, ndër të tjera, ka shpjeguar se llogarinë bankare ku ka depozituar *cash* shumën 1,000,000 lekë e ka deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2008 dhe se burimi i saj është përfitimi i të ardhurave nga shitja e banesës 1+1 në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës, në vitin 2002. Subjekti shpjegon se është e vërtetë se këto të ardhura nuk i ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2003 dhe 2004, pasi nuk ka qenë subjekt deklarimi në funksionin që ka pasur si OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

**1.9.7** Bazuar në dokumentacionin shkresor të dorëzuar prej tij, subjekti shpjegon se ka provuar tej çdo dyshimi, *së pari*, se shitja e banesës së lartpërmendur është reale dhe se, *së dyti*, këto të ardhura dhe këtë shumë e ka pasur gjendje *cash* që nga viti 2002 e deri në shtator të vitit 2008, shumë të cilën e ka depozituar në “Intesa Sanpaolo Bank”, fillimisht në llogari rrjedhëse dhe më pas në janar të vitit 2009 në depozitë.

**1.9.8** Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në DIPP-në e viteve 2003 dhe 2004, kur subjekti ka qenë në detyrën e OPGJ-së (pra jo i detyruar për të plotësuar deklaratat) dhe përfitimi i shumës 1,000,000 lekë nga ana e tij tej çdo dyshimi, subjekti gjykon se duhet të vlerësohet nga Komisioni si një pasaktësi e paqëllimshme.

**1.9.9** Për mosshlyerjen e huas prej 30,000 euro brenda afatit 5-vjeçar të përcaktuar në kontratën e huas, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se këstet e saj, me mirëkuptim midis palëve, janë vendosur të paguhet nga viti 2018 dhe kjo hua e marrë është shlyer plotësisht nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në fund të vitit 2022, vërtetuar me mandatpagesat e kryera në “Fibank”.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**1.9.10** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimet e Komisionit. Për një nga burimet e blerjes së njësisë dyqan, që është edhe shuma 10,000 euro, nga verifikimi i bërë nga Komisioni ka rezultuar se kjo shumë është pjesë përbërëse e shumës 1,268,853 lekë, e cila është tërhequr nga llogaria bankare në datën 14.1.2013. Nga veprimet bankare, shuma prej 1,268,853 lekësh është krijuar nga shuma 1,000,000 lekë e depozituar *cash* nga subjekti i rivlerësimit në datën 4.9.2008, si dhe diferenca tjetër nga interesat

---

<sup>18</sup> Shihni rezultatet e hetimit administrativ.



bankarë. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shuma prej 1,000,000 lekësh e depozituar në ISP Bank ka si burim shitjen e apartamentit 1+1 të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës, në vitin 2002. Nga verifikimi i deklaratave të pasurisë pas emërimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin e prokurorit rezulton se shuma prej 1,000,000 lekësh është deklaruar nga subjekti në DPFĐ-në e vitit 2008 si vlerë e përfituar nga shitja e banesës 1+1 në vitin 2002, për të cilën subjekti ka depozituar edhe kontratën përkatëse. Gjithashtu, subjekti, në po këtë deklaratë, deklaroi llogari rrjedhëse pranë ISP Bank me të ardhura nga shitja e banesës 1+1 në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës, që i korrespondojnë shumës 1,000,000 lekë. Në këtë këndvështrim, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i shumës 1,000,000 lekë nga ana e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e viteve 2003 dhe 2004 nuk mund të konsiderohet si veprim i bërë me qëllim fshehjeje apo shmangieje në deklaram, por vlerësohet si pasaktësi në deklaram, pasaktësi kjo që nuk e penalizon subjektin e rivlerësimit, pasi vetë ky i fundit e ka deklaruar këtë shumë në DPFĐ-në e vitit 2008 kur është emëruar në funksionin e prokurorit, po kështu është deklaruar edhe nga bashkëshortja e tij në DIPP-në e vitit 2013 si një nga burimet e blerjes së dyqanit, si dhe në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu, nga analiza financiare për vitet 2003 dhe 2004 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit figuron me një balancë pozitive për dy vitet e deklaramit si OPGJ.

**1.9.11** Komisioni mban në konsideratë gjithashtu edhe pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit deklaramet e pasurisë ndër vite në ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe një status të tillë e zotëron edhe deklarata para fillimit të detyrës së pasurisë të vitit 2008, ku është deklaruar saktë llogaria rrjedhëse pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, Durrës, në shumën 1,000,000 lekë, me burim shitjen e banesës 1+1 në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës.

**1.9.12** Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se shuma prej 10,000 euro, e deklaruar në deklaratën *Vetting* si një nga burimet e blerjes së njësisë dyqan, ka burime të ligjshme të verifikueshme dhe, për këtë qëllim, Komisioni e ka përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë e llojit “njësi”, si dhe ka burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.**

**2. Automjet tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, blerë në datën 18.1.2012, në vlerën 25,000 euro.** Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: (a) të ardhura nga kursime familjare, paga e punës; (b) të ardhura nga shitja gjatë viteve 2006 – 2011 e disa automjeteve që kanë qenë në pronësi të subjektit.

**Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**2.1** Subjekti e ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në DIPP-në e vitit 2012, me pjesë takuese 100%, në shumën 25,000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës<sup>19</sup> të automjetit.

---

<sup>19</sup> Certifikatë pronësie dhe leje qarkullimi e automjetit tip “Toyota RAV4”, e vitit 2012, me targa \*\*\*, dokument doganor i datës 10.2.2012, ku rezultoi i pasqyruar vlera e këtij automjeti në shumën 25,074 euro dhe për të cilin është paguar taksa doganore nga subjekti i rivlerësimit në shumën 701,022 lekë; dokument i lëshuar nga shitësi, shoqëria “\*\*\*\*”, ku i shet këtë automjet z. Sokol Nishan në vlerën 25,074 euro.

**2.2** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor<sup>20</sup> (në vijim DPSHTRR) konfirmon se z. Sokol Nishani ka pasur të regjistruar në pronësi të tij automjetin tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*. Rezulton se ky automjet është blerë tek shoqëria “\*\*\*\*” s.r.l., me rezidencë në Itali nga z. Sokol Nishani, në datën 18.1.2012, për çmimin 24,200 euro ose 3,339,358 lekë<sup>21</sup>, sipas faturës përkatëse. Nga dokumenti doganor i datës 10.2.2012 rezulton se subjekti Sokol Nishani ka paguar taksën doganore në shumën 701,022 lekë. Automjeti i është shitur me kontratën e datës 14.12.2020<sup>22</sup> blerësit D. Sh., për çmimin 11,000 euro<sup>23</sup>.

**2.3** Subjekti i rivlerësimit, kur është pyetur në ILDKPKI<sup>24</sup> në vitin 2016 që të sqarojë burimin e automjetit tip “Toyota”, blerë në vlerën 25,000 euro në vitin 2012, ka shpjeguar se *1,400,000 lekë janë nga shitja e automjetit tip “Toyota” me targa \*\*\* dhe tepricat e likuiditetit nga paga e viteve 2010 e 2011, në shumën rreth 1,300,000 lekë.*

**2.4** Në pyetësorin standard në lidhje me burimin e shumës prej 24,200 euro, paguar për blerjen e automjetit tip “Toyota”, subjekti sqaron se një pjesë e saj prej 10,000 euro është marrë dhe siguruar në formën e huas tek vëllai i tij I. N., hua e cila nuk është dokumentuar me shkresë, ndërkohë e gjithë shuma prej 14,000 euro është siguruar nga shitja e automjetit tip “Toyota” në shumën 1,400,000 lekë apo 10,000 euro, si dhe rreth 4,200 euro të siguruara nga kursimet familjare nga pagat e punës së subjektit dhe bashkëshortes.

**2.4.1** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale datë 29.7.2020<sup>25</sup>, me deklarues I. N., i cili, ndër të tjera, deklaroi: *“Unë, deklaruesi I. N., jam vëllai i shtetasit Sokol Nishanit dhe deklaroj se në muajin janar 2012 i kam dhënë borxh shumën prej 10,000 euro për blerjen e automjetit nga ana e tij në shtetin italian, shumë e cila më është likuiduar ndër vite. Duke qenë se jemi vëllezër nuk kemi mbajtur ndërmjet nesh deklarata borxhi apo akte të tjera për të vërtetuar këtë fakt, për atë periudhë kohe”.*

**2.4.2** Në lidhje me mosdeklarimin si shpenzim në DIPP-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* të taksës doganore të paguar në datën 10.2.2012, në shumën 701,022 lekë, për blerjen e automjetit, subjekti ka shpjeguar se ka nënkuptuar si deklaram në rastin në fjalë vetëm çmimin e blerjes në shumën 25,000 euro.

**2.5** Në lidhje me mospërputhjet mbi burimin e krijimit të shumës 25,000 euro, pasi subjekti ka deklaruar në pyetësorin nr. 2, ndër të tjera, ka shpjeguar se e gjithë shuma në total prej 29,234 euro (24,200 euro + 701,022 lekë dogana ose 5,034 euro) është siguruar nga burime financiare të ligjshme të verifikueshme dhe të dokumentuara, si vijon:

<sup>20</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>21</sup> Çmimi 24,200 euro ose 3,339,358 lekë, sipas kursit të datës 18.1.2012, ku 1 euro = 137.99 lekë.

<sup>22</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.12.2020.

<sup>23</sup> Konfirmuar kjo nga mandatpagesa e datës 14.12.2020, lëshuar nga “Raiffeisen Bank”, pagesë D. Sh. 11,000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*.

<sup>24</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së.

<sup>25</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.7.2020.

*Së pari*, shuma 10,000 euro është marrë hua tek vëllai i tij I. N. në janar të vitit 2012, i cili për shkak të punësimit të tij prej rreth 14 vitesh në emigracion në Itali, që nga viti 1991 deri në vitin 2004, ka pasur dhe disponon edhe sot të ardhurat e duhura financiare.

*Së dyti*, shuma prej 1,400,000 lekësh ose 10,000 euro janë të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, në fillim të vitit 2012.

*Së treti*, e gjithë shuma tjetër financiare është siguruar nga shitja e dy automjeteve tip “Mercedes-Benz” dhe “KIA”, për shumën totale 10,000 euro, nëntor të vitit 2009.

*Së katërti*, kursimet financiare të siguruar nga paga e subjektit si prokuror dhe të bashkëshortes ndër vite deri në fund të 2011 (konstatohet se rezultatet financiare për vitet 2009, 2010 dhe 2011 janë përkatësisht: +932,336 lekë +237,703 lekë dhe +728,539 lekë).

### **Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të burimit të krijimit për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, si vijon:**

#### **2.6 Burimi i parë i deklaruar – kursimet familjare nga paga**

Nga leximi i deklaratës periodike të vitit 2011 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar kursime *cash* në vitin 2011, por rezultati financiar i vitit 2011 rezulton të jetë +728,539 lekë. Sipas dokumentacionit të depozituar në pyetësin standard për pagesën e automjetit në vlerën 24,200 euro, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur transfertën bankare të datës 17.1.2012, kryer në ISP Bank, me urdhërues I. N. dhe përfituese shoqëria “\*\*\*”, me përshkrimin “blerje mjeti ‘Toyota RAV4’ për Sokol Nishani”. Nga data 1.1.2012 deri më 17.1.2012 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij rezultojnë se kanë tërhequr nga llogaritë e tyre bankare shumën 65,000 lekë.

#### **2.7 Burimi i dytë i deklaruar – të ardhurat nga shitja e mjeteve në periudhën 2006 – 2011**

Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, si dhe ai i administruar nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2006 – 2011 ka shitur në të njëjtën datë, 16.11.2009, dy automjete, tip “KIA” (blerë në vitin 2006) dhe tip “Mercedes-Benz” (blerë në vitin 2008). Të ardhurat nga shitja e automjeteve në vitin 2009 nuk janë deklaruar si kursim *cash* në DIPP-në e vitit 2009, por shitja e këtyre automjeteve është deklaruar në DIPP e vitit 2009 e për rrjedhojë edhe si të ardhura.

### **Në lidhje me automjetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si burim për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4”, blerë në vitin 2012**

**a) Automjeti tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, blerë në vitin 2009 në vlerën 400,000 lekë dhe shitur në vitin 2012 në shumën 1,400,000 lekë**

**2.8** Komisioni, referuar deklaratës të subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, që një nga burimet e shumës 25,000 euro është edhe shuma 1,400,000 lekë e përfituar nga shitja e automjetit tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, ka analizuar veprimet e blerjes dhe shitjes së këtij të fundit, si në vijim. Për këtë automjet, subjekti ka deklaruar blerjen e tij në shumën 400,000 lekë në DIPP-në e vitit 2009 dhe shitjen e tij në shumën 1,400,000 lekë në DIPP-në e vitit 2012.

**2.8.1** DPSHTRR-ja<sup>26</sup> ka konfirmuar se ky automjet është përfituar nga subjekti me kontratën e shitblerjes datë 15.11.2009<sup>27</sup>, nga shitësja I. K., me çmimin 400,000 lekë. Kjo e fundit e kishte blerë automjetin në Gjermani në datën 20.7.2009, në vlerën 3,000 euro ose 387,000 lekë<sup>28</sup> dhe ka paguar taksën doganore në datën 24.7.2009, në shumën 256,206 lekë. Në total, automjeti ka kushtuar 643,206 lekë dhe pas 3 muajsh ia shet subjektit të rivlerësimit për çmimin 400,000 lekë, humbje me vlerë 243,206 lekë. Më pas, me kontratën e shitblerjes datë 14.4.2012<sup>29</sup>, subjekti Sokol Nishani ia shet blerësve L. B. e L. K. me çmimin 1,400,000 lekë.

**2.8.2** Me pyetësorin nr. 2 subjektit i është kërkuar të shpjegojë blerjen e automjetit në vlerën 400,000 lekë, kur 3 muaj më parë vetë shitësit i ka kushtuar në total 643,206 lekë, duke e shitur me humbje 243,206 lekë. Subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur dijeni sa i ka kushtuar shitësit automjeti kur e ka blerë, por shpjegon se blerja e tij me çmimin 400,000 lekë është ndikuar nga fakti se automjeti në atë periudhë nuk ishte në gjendje të mirë motorike.

**2.8.3** Komisioni ka analizuar burimin e blerjes së automjetit tip “Toyota” me datë 15.11.2009, në vlerën 400,000 lekë, ku në pyetësorin nr. 2 ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e mjeteve tip “KIA” dhe “Mercedes-Benz”<sup>30</sup>, të shitura më parë. Nga sa më sipër, të ardhurat nga shitja e mjeteve janë marrë në datën 16.11.2009, ndërsa blerja e mjetit është kryer një ditë më parë, në datën 15.11.2009. Në kontratën e shitjes citohet se shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Komisioni, duke marrë në konsideratë se transaksioni i blerjes ka ndodhur vetëm një ditë pas atij të shitjes, për të cilin konfirmohet se shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale, i konsideroi të ardhurat e përfituara nga shitja e mjeteve si burim i ligjshëm për pagesën e çmimit 400,000 lekë.

**2.8.4** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>31</sup>, e cila konfirmon se në ngarkim të shtetasve L. B. dhe I. K. nuk rezulton të ketë të regjistruar procedime penale.

**2.8.5** Komisioni ka analizuar momentin e shitjes së automjetit të parë tip “Toyota”, datë 14.4.2012, në vlerën 1,400,000 lekë.

**2.8.6** Subjekti i rivlerësimit, kur është pyetur në ILDKPKI<sup>32</sup> me procesverbalin e datës 31.3.2016 për shitjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, për çmimin 1,400,000 lekë, kur në vitin 2009 është blerë 400,000 lekë, ai ka shpjeguar se automjeti është blerë në Gjermani me çmim blerjeje rreth 2,500 euro dhe ka paguar 400,000 lekë, pasi mjeti nuk ishte në gjendje të mirë motorike. Më pas subjekti ka shpenzuar rreth 5,000 euro për vendosje motori.

---

<sup>26</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, e DPSHTRR-së.

<sup>27</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.11.2009.

<sup>28</sup> Sipas kursit të këmbimit të datës 20.7.2009, ku 1 euro = 129 lekë.

<sup>29</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 14.4.2012.

<sup>30</sup> Në pyetësorin nr. 2 subjekti në shpjegimet e dhëna për burimin e krijimit të automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, ka deklaruar: “[...] se e gjithë shuma tjetër financiare është siguruar nga shitja e dy automjeteve ‘Benz’ dhe ‘KIA’ për shumën totale 10,000 euro në muajin nëntor 2009 (ku këtu duhet pasur parasysh edhe fakti i blerjes nga ana ime po në muajin nëntor të vitit 2009 i automjetit ‘RAV4’ për shumën 400,000 lekë të reja), si dhe kursime financiare të siguruara nga pagat...”.

<sup>31</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>32</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së.

**2.8.7** Në lidhje me mosdeklarimin e shpenzimeve të kryera për këtë automjet në DIPP-në e vitit 2009 në vlerën 5,000 euro, subjekti ka shpjeguar se ka shpenzuar rreth 5,000 euro për vendosje motori të ri dhe punime të tjera. Kjo pagesë i është bërë shtetasit N. Ç. përgjatë 3 viteve, për shkak të miqësisë me të, përkatësisht viti 2009 (paguar 2,000 euro), viti 2010 (paguar 1,500 euro) dhe viti 2011 (paguar 1,500 euro)<sup>33</sup>.

**2.8.8** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në pyetësorin standard se ndërmjet tij dhe blerësit L. B., me mirëkuptim të plotë dhe pëlqim paraprak për shkak të nevojës që kishte për blerjen e automjetit në Itali, ishte bërë që në fillim të muajit janar 2012 *de facto* dhënia apo dorëzimi i automjetit tek ky person dhe njëkohësisht marrja prej tij nga ana e subjektit e shumës 1,400,000 lekë, për të cilin kishin rënë dakord për shitblerjen në fjalë.

**b) Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\***, i vitit 1998, blerë nga z. Sokol Nishani në vitin 2006, në vlerën 200,000 lekë dhe shitur në vitin 2009, në vlerën 5,000 euro

**2.9** Në DPDFD-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 550,000 lekë, me burim “kursimet nga paga dhe shitja e një apartamenti 1+1 në L. \*\*\*, Durrës”. Në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit në vlerën 5,000 euro, sipas kontratës datë 16.11.2009.

**2.9.1** DPSHTRR-ja<sup>34</sup> konfirmon se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, është përfituar nga kontrata e shitblerjes datë 19.6.2006<sup>35</sup>, me shitës H. P., për çmimin 200,000 lekë ose 1,612 euro<sup>36</sup>. Rezulton se për këtë automjet, më 14.12.2006, subjekti Sokol Nishani ka paguar detyrimin doganor në vlerën 256,190 lekë. Nga dokumentacioni rezulton se vetë shitësi H. P. e ka blerë këtë automjet në shtetin italian në datën 24.3.2006, në vlerën 3,500 euro.

**2.9.2** Komisioni vëren se shitësi H. P. e ka shitur këtë automjet pasi e kishte blerë vetë, pas 3 muajsh me humbje në vlerën 1,888 euro, çka bën të mendohet se çmimi prej 200,000 lekësh, deklaruar në kontratën e shitblerjes, nuk është çmimi real. Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.11.2009, z. Sokol Nishani ia shet këtë automjet shtetasit A. C., për çmimin 5,000 euro.

**2.9.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasit H. P. dhe A. C. dhe nga hetimi<sup>37</sup> nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**2.9.4** Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 456,190 lekë.

**2.9.5** Subjekti në pyetësorin nr. 2 ka deklaruar se automjeti tip “Mercedes-Benz” është blerë me të ardhurat nga kursimet e pagës së tij dhe të bashkëshortes E. N. ndër vite, deri në qershor të vitit

---

<sup>33</sup> Subjekti ka depozituar si provë deklaratën noteriale datës 12.12.2022, ku shtetasi N. Ç. mbështet deklaratimet e subjektit për kryerjen e punimeve të ndryshme nga ana e tij në shumën 5,000 euro, në muajt nëntor dhe dhjetor 2009, pagesë e bërë në 3 këste (në 2009-ën paguar shuma 2,000 euro, në 2010-ën paguar shuma 1,500 euro dhe në 2011-ën paguar shuma 1,500 euro). Ka depozituar gjithashtu dokumentacionin që vërteton ushtrimin e aktivitetit si person fizik nga shtetasi N. Ç., NIPT, ekstrakt.

<sup>34</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>35</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 19.6.2006.

<sup>36</sup> Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 14.12.2006, ku 1 euro = 124 lekë.

<sup>37</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2006 dhe nga përfitimi i një shume prej 300,000 lekësh nga shitja në nëntor të vitit 1999 të një banese familjare prej 57 m<sup>2</sup>, e cila ka qenë në bashkëpronësi me prindërit dhe dy vëllezërit<sup>38</sup>.

**2.9.6** Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit në datën 19.6.2006 me të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes. Analiza financiare pasqyron të dhënat për periudhën 1.1.2005 – 19.6.2006, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* në DIPP-në e vitit 2004, duke arritur në konkluzionin se të ardhurat para kësaj periudhe janë shpenzuar. Nga analiza duket se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën 456,190 lekë, në datën 19.6.2006, pasi ka rezultuar me balancë pozitive<sup>39</sup>.

**2.9.7** Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 16.11.2009, me çmimin 5,000 euro ose 688,550 lekë<sup>40</sup>, Komisioni mori në konsideratë si të ardhura të ligjshme për vitin 2009 vetëm shumën 456,190 lekë, pasi shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” i vitit 1998, pas 3 vitesh përdorimi nga ana e subjektit (2006 – 2009), me vlerë 232,360 lekë më shumë se ai i blerjes, përbën një veprim financiar të pajustificuar.

**c) Automjeti tip “KIA” i vitit 2005, me targa \*\*\***, blerë nga subjekti Sokol Nishani në vitin 2008 në vlerën 490,000 lekë dhe shitur në vitin 2009 në vlerën 5000 euro

**2.10** Në DPFD-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën 750,000 lekë, me pjesë takuese 100%, me burim “kursimet nga paga dhe shitja e një apartamenti 1+1 në L. \*\*\*, Durrës”. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar shitjen e tij me çmimin 5,000 euro.

**2.10.1** I pyetur në ILDKPKI me procesverbalin e datës 31.3.2016 në lidhje me deklarimin e këtij automjeti në DPFD-në e vitit 2008, me vlerë 750,000 lekë, ndërkohë që ka depozituar kontratën e blerjes së tij në datën 8.6.2008, duke pasqyruar në kontratë çmimin 490,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se tek vlera e deklaruar është përfshirë edhe zhdoganimi dhe targimi i automjetit me targa \*\*\*.

**2.10.2** DPSHTRR-ja<sup>41</sup> konfirmon se automjeti është përfituar nga subjekti me kontratën e shitblerjes datë 8.6.2008<sup>42</sup>, nga shitësi G. K., me çmimin 490,000 lekë. Nga dokumentacioni rezulton se vetë shitësi G. K. e ka blerë këtë automjet në shtetin italian në çmimin 4,200 euro, sipas deklaratës së shitjes me një shtetas italian, por që nuk ka datë të referuar në të. Rezulton se në datën 6.4.2008 shtetasi G. K. ka paguar detyrimin doganor në vlerën 165,408 lekë ose 1,337 euro<sup>43</sup> dhe në total automjeti ka kushtuar 5,537 euro ose 676,123 lekë. Pas 2 muajsh shtetasi G. K. ia shet

---

<sup>38</sup> Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes së apartamentit me nr. \*\*\*, datë 15.11.1999, me palë shitëse F., T., B., I. dhe Sokol Nishani dhe palë blerëse I. H., për apartamentin e banimit me sip. 57.02 m<sup>2</sup>, me çmimin 1,000,000 lekë, si dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.12.2022, me deklarues F. dhe I. N., në të cilën konfirmohen shpjegimet e dhëna nga subjekti.

<sup>39</sup> Shihni rezultatet e hetimit administrativ. Analiza për periudhën 1.1.2005 – 19.6.2006 ku rezulton: të ardhura = 1,162,441 lekë; të ardhura nga paga e subjektit = 834,860 lekë; të ardhura nga paga e bashkëshortes = 327,580 lekë; detyrime = 0 (zero); shpenzime = 758,186 lekë; shpenzime jetike = 641,134 lekë; shpenzime udhëtimi = 117,053 lekë; pasuri = 321,920 lekë; ndryshim likuiditeti (gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim) = 134,270 lekë; automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, blerë më 19.6.2006 = 456,190 lekë; të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = 82,334 lekë.

<sup>40</sup> Konvertuar me kursin e këmbimit të euros 137.71, të datës 16.11.2009, sipas BOA-s.

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2022, e DPSHTRR-së.

<sup>42</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 8.6.2008.

<sup>43</sup> Sipas kursit të këmbimit të pasqyruar në dokumentin doganor të datës 6.4.2008, ku 1 euro = 123.7 lekë.

subjektit Sokol Nishani 186,123 lekë më lirë. Me kontratën e shitblerjes datë 16.11.2009, subjekti Sokol Nishani ia shet blerësit A. C. me çmimin 5,000 euro ose 688,550 lekë<sup>44</sup>.

**2.10.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shtetasin G. K. dhe nga hetimi<sup>45</sup> nuk rezultoi një situatë e tillë.

**2.10.4** Komisioni ka analizuar burimin e krijimit të shumës 490,000 lekë të blerjes së automjetit tip “KIA”, bazuar në deklarin e DPFD-së së vitit 2008.

**2.10.5** Subjekti ka deklaruar në pyetësonin nr. 2 se burimi i krijimit për blerjen e automjetit tip “KIA” janë të ardhurat e siguruar nga kursimet e pagës së tij dhe të bashkëshortes ndër vite, deri në qershor 2008.

**2.10.6** Komisioni kreu analizën financiare për mundësinë e blerjes së automjetit në datën 8.6.2008 me të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti nuk i ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit si kursime *cash* në DIPP-të e viteve 2003 dhe 2004 dhe, si të tilla, ato nuk mund të jenë përdorur më pas (në vitin 2006 ose 2008). Nga analiza deri në këtë fazë të hetimit rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën 490,000 lekë, në datën 19.6.2006, pasi nga analiza financiare kanë rezultuar me balancë negative në shumën -263,822 lekë<sup>46</sup>.

**2.10.7** Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 16.11.2009, në çmimin 5,000 euro ose 688,550 lekë<sup>47</sup>, Komisioni mori në konsideratë si të ardhura të ligjshme për vitin 2009 vetëm shumën 490,000 lekë, pasi shitja e automjetit tip “KIA” me vlerë 198,550 lekë më shumë se çmimi i blerjes pas përdorimit të tij dhe normës së amortizimit përbën një veprim financiar të pajustificuar.

**2.10.8** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar në lidhje me automjetet, si vijon:

**i. Për automjetin tip “Toyota RAV4”, blerë në vitin 2012, në shumën 25,000 euro, duket se:**

a) *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e automjetit tip “Toyota RAV4” në DIPP-në e vitit 2012.*

b) *Nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 dhe në deklaratën Vetting shpenzimet mbi vlerën 300,000 lekë, sipas ligjit nr. 9049/2003 (shpenzime doganore 701,022 lekë).*

c) *Ka bërë deklarime kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e automjetit, pasi ka deklaruar: (i) në deklaratën Vetting: 1) kursime familjare; 2) të ardhura nga shitja e mjeteve për vitet 2006 – 2011; (ii) në procesverbalin e vitit 2016 në ILDKPKI: 1) 1,400,000 lekë shitje nga automjeti tip “Toyota”, në datën 14.4.2012; dhe 2) 1,300,000 lekë tepricat e likuiditetit nga pagat e viteve 2010 dhe 2011; (iii) në pyetësonin standard: 1)10,000 euro hua marrë nga vëllai*

<sup>44</sup> Sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 16.11.2009, ku 1 euro = 137.71 lekë.

<sup>45</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>46</sup> Shihni rezultatet e hetimit administrativ. Periudha 19.6.2006 – 8.6.2008. Të ardhura = 2,147,702 lekë; të ardhura nga periudha të mëparshme = 82,334 lekë; të ardhura nga paga e subjektit = 1,158,322 lekë; të ardhura nga paga e bashkëshortes = 907,046 lekë; detyrime = 0 (zero); shpenzime = 1,693,912 lekë; shpenzime jetike = 1,417,250 lekë; shpenzime udhëtimi = 276,662 lekë; pasuri = 717,612 lekë; ndryshim likuiditeti (gjendje likuiditeti në fund - gjendje likuiditeti në fillim) = 227,612 lekë; automjet tip “KIA” me targa \*\*\*, blerë më 8.6.2008 = 490,000 lekë; të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = -263,822 lekë.

<sup>47</sup> Konvertuar me kursin e këmbimit të euros 137.71, të datës 16.11.2009, sipas BOA-s.

*I. N. në janar të vitit 2012; 2) të ardhura nga shitja e automjetit tip “Toyota” 1,400,000 lekë ose 10,000 euro; dhe 3) 4,200 euro nga pagat.*

*d) Nuk ka deklaruar huan e marrë të vëllait në shumën 10,000 euro në DIPP-në e viteve 2012 – 2016 dhe në deklaratën Vetting. Duket se kjo është një përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të rregulluar situatën financiare me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, Komisioni nuk e ka marrë atë në konsideratë.*

*e) Duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Toyota RAV4” në datën 14.4.2012 nuk mund të jenë përdorur si burim për blerjen e automjetit tjetër tip “Toyota RAV4” më 18.1.2012.*

*f) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 24,200 euro + 701,022 lekë, për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012.*

#### **ii. Për automjetin tip “Mercedes-Benz”, duket se:**

*a) Ka mospërputhje deklarimi për vlerën e automjetit tip “Mercedes-Benz”: (i) në DPFDD-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar vlerën e automjetit 550,000 lekë; ndërsa (ii) në kontratën e shitjes datë 19.6.2006 pasqyrohet çmimi 200,000 lekë dhe vlera doganore e paguar nga subjekti sipas deklaratës doganore është 256,190 lekë.*

*b) Shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, i vitit 1998, pas 3 vitesh përdorimi nga ana e subjektit (2006 – 2009), me vlerë 232,360 lekë më shumë se ai i blerjes, përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe Komisioni mori në analizë vetëm shumën 490,000 lekë.*

#### **iii. Për automjetin tip “KIA”, duket se:**

*a) Ka mospërputhje deklarimi për vlerën e automjetit me targa \*\*\*: (i) në DPFDD-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar vlerën e automjetit 750,000 lekë; ndërsa (ii) në kontratën e shitjes datë 8.6.2008 pasqyrohet çmimi 490,000 lekë dhe vlera doganore nuk provohet të jetë paguar nga subjekti i rivlerësimit.*

*b) Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën 263,822 lekë.*

**iv. Për tri automjetet e analizuar më lart, përfshirë edhe automjetin tip “Rover” (të bashkëshortes së subjektit), duket se: blerja e tyre me çmim të lirë dhe shitur me çmim më të lartë pas përdorimit të tyre duket se është veprim i përsëritur dhe përpjekje e subjektit të rivlerësimit për të rregulluar situatën financiare me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit tip “Toyota RAV4” me të ardhura të ligjshme.**

Për konstatimet mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**2.11** Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka shpjeguar si vijon:



**2.11.1** Për mosdeklarimin e burimit të krijimit të automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, subjekti ka shpjeguar se ka qenë një harresë apo pakujdesi e tij, pasi nuk ka pasur asnjë interes për të mos e deklaruar atë.

**2.11.2** Për mosdeklarimin në DIPP-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* të shpenzimeve mbi vlerën 300,000 lekë, sipas ligjit nr. 9049/2003 (shpenzimet doganore 701,022 lekë), subjekti ka shpjeguar se edhe kjo ka qenë pakujdesi e tij dhe nuk ka pasur asnjë lloj veprimi për ta fshehur apo mosdeklaruar atë, pasi ai vetë ka bashkëngjitur deklaratën e zhdoganimit të këtij mjete.

**2.11.3** Për deklarimet kontradiktore në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e automjetit, subjekti rikonfirmon se burimi i të ardhurave financiare për blerjen e automjetit të mësipërm kanë qenë: (a) 10,000 euro të marra hua në janar të vitit 2012 nga vëllai i tij I. N.; (b) 1,400,000 lekë nga shitja e automjetit tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, shtetasit L. B.; (c) 1,500,000 lekë likuiditete, të cilat subjekti dhe bashkëshortja e tij i dispononin realisht *cash* në banesë.

**2.11.4** Për huan në shumën 10,000 euro, marrë nga vëllai I. N., është fakt i vërtetë që ka ndodhur mes subjektit dhe të vëllait në fillim të janarit 2012, gjë e cila provohet si nga shpjegimet e subjektit në pyetësin nr. 2, ashtu edhe nga deklarata noteriale datë 29.7.2022 e të vëllait, si dhe fakti që i vëllai e ka pasur këtë shumë financiare nga puna e tij e ligjshme, qoftë në Itali si emigrant ekonomik prej më shumë se 14 vitesh, por edhe puna e tij në Shqipëri pas kthimit nga emigracioni gjatë viteve në vazhdim.

**2.11.5** Për shumën 1,400,000 lekë nga shitja e automjetit tip “Toyota RAV4”, me targa \*\*\*, shtetasit L. B., fakt i cili provohet nga shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësin nr. 2, nga kontrata e shitjes së automjetit e datës 14.4.2012 dhe nga deklarata noteriale e datës 30.3.2023, e shtetasit L. B., në përmbajtje të së cilës deklarohet se ky shtetas në fillim të muajit janar 2012 ka lidhur marrëveshje verbale me subjektin për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4”, moment në të cilin kur ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë ka likuiduar shumën 1,400,000 lekë dhe finalizimi i kalimit të kësaj prone është bërë me kontratën e shitjes së datës 14.4.2012 dhe se kjo diferencë kohore ka shërbyer për të vërtetuar gjendjen teknike të automjetit të blerë.

**2.11.6** Për shumën 1,500,000 lekë si likuiditete nga pagat, subjekti ka shpjeguar se të ardhurat nga paga si familje, duke zbritur shpenzimet e nevojshme, është e dukshme një diferencë pozitive prej rreth 2,000,000 lekësh (përlllogaritur nga vetë Komisioni), ku një pjesë e saj është përdorur për plotësimin e shumës së blerjes së automjetit prej 24,200 euro dhe 701,022 lekë detyrim doganor.

**2.11.7** Për mosdeklarimin e huas së vëllait në shumën 10,000 euro në DIPP-të e viteve 2012 – 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegon se është një fakt absolutisht real dhe i vërtetë i ndodhur mes dy vëllezërve dhe subjekti garanton se nuk ka qenë përpjekje për të rregulluar situatën financiare me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme. Arsyeja e mosdeklarimit të kësaj huaje në deklaratat e pasurisë ka të bëjë me faktin se meqenëse subjekti nuk e kishte përpiluar apo konkretizuar këtë hua me një dokument shkresor dhe ligjor, nuk mund ta deklaronte dhe dokumentonte në atë periudhë kohore, por edhe më pas një fakt të tillë të ndodhur mes vëllezërve.

**2.11.8** Për automjetin tip “Mercedes-Benz” në lidhje me mospërputhjet në deklaram për vlerën e tij, subjekti sqaron se nga ana e tij ka qenë thjesht lapsus në deklaramin e bërë, pasi automjeti është blerë në shumën 200,000 lekë.

**2.11.9** Për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, i vitit 1993, pas 3 vitesh përdorimi me vlerë më të lartë se ajo e blerjes, subjekti ka shpjeguar se shuma e përfituar në nëntor të vitit 2009 është pikërisht ajo e shënuar në kontratën e shitblerjes datë 16.11.2009 në vlerën 5,000 euro, kjo për shkak të shërbimeve mjaft të mira dhe cilësore të kryera në funksion të mirëmbajtjes nga ana teknike, motorike etj., gjatë kohës së përdorimit të tij nga ana e subjektit.

**2.11.10** Për automjetin tip “KIA” në lidhje me mospërputhjet në deklaram për vlerën e tij, subjekti ka shpjeguar se garanton dhe deklaron me përgjegjësi ligjore se edhe për këtë rast ka qenë lapsus, gabim ky për shkak të periudhës së largët kohore kur ky mjet dhe deklarami i bërë për vlerën 750,000 lekë është gabim, pasi automjeti në fjalë është blerë në shumën 490,000 lekë dhe garanton se shuma 5,000 euro e përfituar nga shitja e këtij automjeti është shuma reale e shënuar në kontratën e shitjes së datës 16.11.2009, kjo për shkak të shërbimeve të ndryshme dhe mjaft cilësore të kryera në funksion të mirëmbajtjes së këtij automjeti (*sqarohet se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 31.3.2016, subjekti ka deklaruar se ka paguar edhe taksën doganore prej 1,337 euro*).

**2.11.11** Për automjetin tip “Rover” në emër të bashkëshortes së tij, subjekti shpjegon dhe garanton se konstatimi i Komisionit nuk është i saktë, pasi blerja e tij në datën 21.10.2013 dhe më pas shitja e tij disa vite më vonë në datën 17.7.2020 nuk ka asnjë lidhje me përpjekjen e subjektit për të rregulluar situatën financiare.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**2.12** Për sa i përket burimit të krijimit të automjetit tip “Toyota RAV4”, blerë në vitin 2012, shpenzimeve doganore të paguara për të, vlerës së deklaruar të automjeteve tip “Mercedes-Benz” dhe “KIA”, subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimet e Komisionit, duke i konsideruar ato si pasaktësi të paqëllimshme në deklaram dhe duke i shpjeguar qartë ato. Komisioni vlerëson se këto pasaktësi nuk arrijnë deri në atë nivel sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, për shkak se ato nuk kanë sjellë pasoja.

**2.13** Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, Komisioni mban në konsideratë dhe vlerëson faktet si vijojnë:

a) Huaja prej 10,000 euro, dhënë subjektit të rivlerësimit nga vëllai i tij në janar të vitit 2012, ashtu siç rezultoi nga hetimi administrativ, është konfirmuar nga vetë subjekti dhe i vëllai (me deklaramin noteriale të datës 29.7.2020), por nuk është materializuar me dokument ligjor, ashtu siç parashikohet në dispozitat e Kodit Civil dhe kjo vlerësohet nga Komisioni për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare vëllazërore ndërmjet këtyre dy personave.

Fakti i ekzistencës së kësaj huaje përforcohet edhe nga veprimi bankar i transferimit të çmimit total prej 24,200 euro të blerjes së automjetit tip “Toyota RAV4” në llogarinë bankare të

shoqërisë “\*\*\*” nga llogaria bankare e vëllait I. N. në datën 18.1.2012, me përshkrimin “blerje mjeti për Sokol Nishanin”.

Gjithashtu konstatohen të ardhura të konsiderueshme të vëllait nga punësimi në Itali, ku vetëm për vitet 2002, 2003 dhe 2004 ka përfituar të ardhura në shumën 51,421<sup>48</sup> euro, mëse të mjaftueshme këto për të mundësuar dhënien e një huaje prej 10,000 euro subjektit të rivlerësimit.

Nisur nga sa më sipër, në kushtet kur kalimi i cmimit të shitjes në llogari të palës shitëse është kryer në rrugë bankare nga llogaria banhare në emër të vëllait, me destinacion të mirëpërcaktuar si dhe në kushtet kur vëllai i subjektit ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huas, vlerësohet se subjekti nuk ka pasur asnjë arsye të mos deklaronte huanë si burim për krijimin e kësaj pasurie. Pra ku mosdeklarim nuk mund të konsiderohet i qëllimshëm si një përpyetje e subjektit për të rregulluar situatën financiare me qëllim justifikimin e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme, dhe për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen si deklarime të pamjaftueshme për efekt të ligjit 84/2016.

- b) Komisioni, gjithashtu, në lidhje me kontratat e shitblerjes së automjeteve (KIA, Mercedes-Benz, Toyota RAV4) dhe vlerave të përcaktuara në to, pavarësisht paqartësive të evidentuara në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerëson se ato janë shprehje e vullnetit të lirë të palëve duke mbajtur në konsideratë dhe dispozitat e Kodit Civil në lidhje me kontratat (neni 659 e në vijim), që përcaktojnë forcën provuese të tyre, të barasvlefshme me vetë fuqinë e ligjit, si dhe natyrën konsensuale të tyre kur ato lidhen në formën e duhur mes palëve<sup>49</sup>. Për më tepër, për sa kohë nuk u vërtetuan raste të konfliktit të interesit të subjektit me palët pjesëmarrëse në këto kontrata, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundime negative që penalizojnë subjektin e rivlerësimit.
- c) Veprimet e shitblerjes së automjeteve janë pasqyruar në deklaratat përkatëse të pasurisë e për rrjedhojë edhe të ardhurat e përfituara prej tyre.
- d) Me deklaratën noteriale datë 12.12.2022, shtetasi N. Ç. konfirmon kryerjen e punimeve për vendosjen e një motori të ri dhe punimeve të tjera, në vlerën totale prej 5,000 euro, në muajt nëntor dhe dhjetor 2009, pagesë kjo e kryer nga ana e subjektit, përkatësisht: viti 2009 – 2,000 euro, viti 2010 – 1,500 euro dhe viti 2011 – 1,500 euro, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin ligjor mbi ushtrimin e aktivitetit të tij, të cilat janë të pasqyruara në deklaratat përkatëse të pasurisë.
- e) Me deklaratën noteriale të datës 30.3.2023, shtetasi L. B. deklaroi lidhjen e marrëveshjes verbale me subjektin për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në fillim të muajit janar 2012, moment në të cilin ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë dhe ka likuiduar shumën 1,400,000 lekë dhe finalizimin e kalimit të pronësisë mbi automjetin me kontratën e shitjes datë 14.4.2012 dhe se kjo diferencë kohore ka shërbyer për të vërtetuar gjendjen teknike të mjetit të blerë.

<sup>48</sup> Shihni dokumentacionin mbi të ardhurat e vëllait të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard.

<sup>49</sup> Shihni vendimin nr. 22 (JR), datë 22.7.2021, të Kolegjit.

- f) Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012 edhe të ardhurat nga shitjet e automjeteve në vitet 2006 – 2011, që i korrespondojnë shitjeve të automjeteve tip “KIA dhe “Mercedes-Benz” në vitin 2009.
- g) Gjithashtu, në lidhje me burimin tjetër të deklaruar në deklaratën *Vetting* për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, konkretisht burimi kursime familjare dhe datën e blerjes së këtij automjeti, 18.1.2012, datë kjo shumë e afërt me datën 31.12.2011, kur përmbillet analiza financiare për vitin 2011, Komisioni mban në konsideratë balancën e shëndoshë pozitive financiare të subjektit dhe personit të lidhur me të, përkatësisht: +728,539 lekë për vitin 2011; +237,703 lekë për vitin 2010; dhe +932,336 lekë për vitin 2009.

**Komisioni, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit<sup>50</sup>, duke marrë në konsideratë në një vlerësim tërësor të gjitha argumentet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar mjaftueshëm burimet financiare të përdorura për blerjen e automjetit tip “Toyota RAV4” në të gjitha elementet e tyre duke justifikuar në një vlerë të konsiderueshme çmimin e blerjes së këtij automjeti, sikurse rezulton nga analiza financiare e rishikuar në përfundim të procesit dhe se pamundësia financiare e mbetur, vlerësohet nga Komisioni me peshë jo aq përcaktuese saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.**

Në këto kushte, paqartësitë dhe mospërputhjet e evidentuara në përfundim të hetimit administrativ për të cilat subjekti ka dhënë mjaftueshëm argumenta, në raport me të gjitha faktet dhe rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

**3. Kredi konsumatore, marrë nga subjekti në “Raiffeisen Bank”, në shumën 510,000 lekë, në datën 18.5.2015.** Deri në datën 31.12.2016 është paguar vlera 409,068 lekë dhe mbetur për t’u paguar vlera 147,821 lekë.

**3.1** Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” në vlerën 510,000 lekë. Në lidhje me destinacionin e kredisë 510,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se ajo është marrë për llogari dhe në ndihmë financiare të njërit prej shokëve të tij dhe, konkretisht, shtetasit I. S., nisur nga fakti se në atë periudhë shoku i tij sapo kishte filluar aktivitetin e një biznesi të vogël, kredi e cila tashmë ka disa vite që është likuiduar muaj pas muaji.

**3.2** Nga dokumentacioni bankar nuk rezulton që kredia të jetë paguar nga shtetasi I. S., por pagesat janë kryer nga vetë subjekti. Kjo kredi është pasqyruar në analizën financiare si shumë e përfituar dhe përdorur nga vetë subjekti dhe pagesat e kryera si shpenzim i tij.

**3.3** Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor se kredia është përdorur dhe paguar nga shtetasi I. S. dhe, për këtë qëllim,

---

<sup>50</sup> Referohuni vendimeve nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit.

i kaloi atij barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**3.4** Subjekti, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar se kjo kredi konsumatore është marrë prej tij për të ndihmuar financiarisht shokun e tij I. S., banor i qytetit të Durrësit, për ngritjen e një aktiviteti të vogël biznesi. Nisur nga fakti që pagimi i kësaj kredie bëhej sipas kontratës së lidhur me “Raiffeisen Bank” nga paga e tij mujore, kuptohet se likuidimi i saj është bërë totalisht nga kjo pagë, ndërsa shtetasi në fjalë, detyrimin e tij financiar ndaj subjektit e ka shlyer muaj pas muaji në ato vlera që mbaheshin nga paga mujore.

### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**3.5** Komisioni vëren se subjekti nuk arriti të provojë që kjo kredi është marrë për të ndihmuar shtetasin I. S.. Nga hetimi administrativ rezultoi se kjo kredi është marrë drejtpërdrejt nga subjekti i rivlerësimit dhe pagesat e kësteve të kredisë janë bërë po nga subjekti, ndërkohë që në asnjë rast nuk ka gjurmë që kjo kredi të jetë marrë për shtetasin I. S. apo edhe pagesat të jenë bërë prej tij.

**Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë që kredia prej 510,000 lekësh ishte marrë për shtetasin I. S. dhe e pasqyroj në analizën financiare si shumë të përfiturar dhe përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe pagesat e kryera si shpenzim i tij.**

### **PERSONI I LIDHUR ME SUBJEKTIN/BASHKËSHORTJA E. N.**

**Pasuria apartament banimi me sip. 146.46 m<sup>2</sup>**, e ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Durrës. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: përfiturar me trashëgimi ligjore nga babai i saj B. C. pas vdekjes së tij, dokumentuar me kontratën e pjesëtimit vullnetar të datës 21.12.2010<sup>51</sup>, si dhe me aktmarrëveshjen datë 28.7.1997<sup>52</sup>, të lidhur me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k.

**3.6** Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010, si pasuri në emër të bashkëshortes E. N.. Bashkë me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar dokumentacionin e përfitimit të këtij apartamenti me origjinë nga vendimet e ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ku vjehri i subjektit, z. B. (V.) C., ka qenë përfitues si trashëgimtar ligjor<sup>53</sup>. Më pas, pjesa e fituar me trashëgimi, me kontratën e pjesëtimit vullnetar datë 21.12.2010<sup>54</sup>

<sup>51</sup> Kontrata e pjesëtimit nr. \*\*\*, datë 21.12.2010.

<sup>52</sup> Aktmarrëveshje nr. \*\*\*, datë 28.7.1997.

<sup>53</sup> (i) Me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.1993, të KKKP-së, i cili vendosi t’u njohë pronësinë trashëgimtarëve të shtetasve Sh. e L. C. (H., V., R. e F. C., H. M., L. D. dhe N. K.) mbi një truall me sip. 6 dynym në qytetin e Durrësit; (ii) me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.3.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në çështjen me paditës F., V., R., H. C., H. M., L. D. dhe N. K., i paditur KKKP-ja, me objekt “plotësimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 29.10.1993, i KKKP-së Durrës të pronave të ish-pronarëve [...]”, gjykata vendosi të pranojë padinë, duke plotësuar vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.1993, të KKKP-së, duke e detyruar atë t’i kthejë paditësve në natyrë sip. 2956 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqja e mbetur prej 3044 m<sup>2</sup> t’ia kompensojë me sipërfaqe ekuivalente. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.8.1996; (iii) me aktmarrëveshjen e datës 28.7.1997<sup>53</sup>, të lidhur ndërmjet shtetasve E. C. (N.), e cila përfaqëson me prokurë shtetasit N. K. dhe B. C., si dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shtetasja N. K. ka në pronësi një sipërfaqe trualli prej 510 m<sup>2</sup>, po kështu edhe shtetasi V. (B.) C. ka në pronësi 510 m<sup>2</sup>. Të dy këta pronarë vënë në dispozicion të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. truallin për ndërtimin e një pallati, ku pronarët e truallit do të marrin 20% të apartamenteve që do të ndërtohet nga shoqëria; (iv) me vendimin e lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 14.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të trashëgimlënësit B. C., duke përcaktuar si trashëgimtarë të radhës së parë shtetasit Sh. C. (bashkëshortja), E. N. (C.), e bija dhe I. L. (C.), e bija që trashëgojnë secila 1/3 pjesë të pasurive të shtetasit B. C.

<sup>54</sup> Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. \*\*\*, datë 21.12.2010.

është ndarë ndërmjet bashkëpronarëve Sh. C., I. C. (L.) dhe E. C. (N.), konkretisht pasuritë apartament me sip. 146.46 m<sup>2</sup>, apartament me sip. 152 m<sup>2</sup> dhe njësi me sip. 40 m<sup>2</sup>, të ndodhura në Lagjen nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, Durrës, ku shtetasja E. C. (N.) merr në pronësi pasurinë apartament me sip. 146.46 m<sup>2</sup>, për të cilin është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie datë 28.12.2012, nga ZVRPP-ja Durrës.

**3.7** ASHK Durrës<sup>55</sup> konfirmon se pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit “apartament”, ka kaluar me kontratë këmbimi nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. në pronësi të shtetasit B. C.. Me vendimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore ka kaluar në pronësi të trashëgimtarëve E. N. (C.), I. L. (C.) e Sh. C. dhe, më pas, me kontratë pjesëtimi ka kaluar në pronësi të shtetasës E. N..

**3.8** Për këtë pasuri edhe nga ana e FSHU-së<sup>56</sup> konfirmohet kontrata e furnizimit me datë hapjeje 30.8.2001, të lidhur me abonentin Sokol Nishani në kabinën “\*\*\*” në instancën Durrës, po kështu edhe Ujësjiellës Kanalizime Durrës (në vijim UKD)<sup>57</sup> konfirmon klientin në sistemin e faturimit Sokol Nishani me kontratë nr. \*\*\*, me adresë Lagjia nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, ap. \*\*\*, h. \*\*\*.

**3.9** Komisioni, me pyetësorin nr. 2, i ka kërkuar subjektit të shpjegojë faktin që lidh vjehrrin e tij B. C. me trashëgimtarët e tjerë me pronat, pasi emri B. C. nuk rezulton në dokumentacionin ku janë përfituar prona nga trashëgimia. Subjekti ka shpjeguar se vjehri i tij B. C. njihej në rrethin familjar, farefisnor dhe shoqëror edhe me emrin V. C. dhe për këtë ka depozituar dokumentacionin provues<sup>58</sup>.

**3.10** Komisioni ka administruar përgjigjen e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., datë 4.12.2022, ku konfirmohet se kjo shoqëri nuk ka lidhur kontrata/aktmarrëveshje etj. me shtetasit S., E. dhe F. N.

**3.11** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi dhe, për këtë qëllim, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>59</sup>, e cila konfirmon se në ngarkim të shtetasit N. J. dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. nuk rezulton të ketë të regjistruar procedime penale.

**Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.**

<sup>55</sup> ASHK Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021.

<sup>56</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2021, e FSHU-së konfirmon kontratën e furnizimit nr. \*\*\*.

<sup>57</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2022, e UKD-së.

<sup>58</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 9.12.2022, i Bashkisë Durrës, që vërteton regjistrimin pranë Njesisë Administrative Nr. \*\*\* të shtetasit B. Sh. C., i datëlindjes 19.9.1932, por nuk konfirmon të regjistruar emrin e shtetasit V. Sh. C., i datëlindjes 19.9.1932; dy pasaporta me emrin B. C. dhe një librezë anëtarësie me emrin V. Sh. C.; aktmarrëveshje datë 28.7.1997, e lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., ku shtetasja E. N. vepron si përfaqësuese e shtetasit B. C.; prokurë e datës 25.7.1997 e shtetasit B. C.; vërtetim pronësie datë 24.10.1995, i shtetasit V. C. etj.; vërtetim hipotekor datë 27.6.2003 i shtetasit B. C.; vendim lëshim dëshmi trashëgimie datë 14.5.2010, i shtetasit B. C. kontratë pjesëtimi vullnetar i datës 21.12.2010, ku përmendet shtetasi B. C.; një deklaratë e datës 11.12.2022 e shtetasve Sh. C. dhe E. N. (C.) e I. L. (C.), përkatësisht bashkëshortja dhe dy vajzat e shtetasit B. C., të cilat deklarojnë se bashkëshorti dhe njëkohësisht babai i tyre B. Sh. C., i datëlindjes 19.9.1932, ka përdorur dhe është njohur në rrethin familjar e më gjerë edhe emrin V. C., me të cilin është prezantuar, njohur dhe nënshkruar mjaft dokumente private dhe shtetërore.

<sup>59</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**4. Depozitë në “Raiffeisen Bank” në shumën 3,598 euro.** Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: shumë e përfituar nga puna si notere dhe, konkretisht, nga kontrata e shitjes së pasurisë datë 29.9.2016<sup>60</sup>, me palë shitëse B. M. dhe palë blerëse shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.<sup>61</sup>.

**4.1** Subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në DIPP-në e vitit 2016 të përfituar nga puna si notere dhe, konkretisht, nga kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.9.2016. Së bashku me deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar edhe kontratën e shitjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme truall + ndërtesë, datë 29.9.2016, me nr. \*\*\*, shitësi B. M. dhe blerësi shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. për pasurinë godinë 3-katëshe me sip. 185 m<sup>2</sup> kati i parë dhe 202 m<sup>2</sup> kati i dytë, me çmimin 1,300,000 euro. Është depozituar edhe fatura tatimore nr. \*\*\* e shitësit E. N. me blerës shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., vlera 3,598 euro (3,588 euro + 10 euro pulla), për kontratën e shitjes<sup>62</sup>.

**4.2** “Raiffeisen Bank”<sup>63</sup> konfirmon kalimin e shumës 3,598 euro në datën 3.10.2016 nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. tek personi fizik “E. N.”, me përshkrimin “likuidim fature nr. \*\*\*, datë 29.9.2016”.

**4.3** Komisioni vëren se nga llogaria bankare e konfirmuar nga “Raiffeisen Bank” nuk ka të bëjë me “depozitë”, ashtu siç është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit, por me kalimin e një pagese në llogari të personit fizik “E. N.”.

**Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë depozitë.**

**5. Automjet tip “Rover” me targa \*\*\*, blerë në datën 21.10.2013, në shumën 1,200 euro.** Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: me të ardhurat financiare nga puna si notere.

**5.1** Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në emër të bashkëshortes me vlerë 1,200 euro dhe detyrime doganore e financiare 54,400 lekë.

**5.2** DPSHTRR-ja konfirmon që automjeti tip “Rover” i vitit 2005, me targa \*\*\*, është blerë nga shtetasja E. N. me kontratën e datës 21.10.2013, në shtetin gjerman, në vlerën 1,200 euro. Nga dokumenti doganor i datës 31.10.2013 për këtë automjet, nga shtetasja E. N. është paguar taksa doganore në vlerën 38,310 lekë ose 271 euro. Në total, automjeti ka kushtuar 1,471 euro. Më pas, me kontratën e datës 17.7.2020<sup>64</sup> shtetasja E. N. ia shet këtë automjet blerësit G. G. në vlerën 2,000 euro.

**5.3** Komisioni ka hetuar edhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi dhe për këtë qëllim ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>65</sup>, e cila konfirmon se në ngarkim të shtetasit G. G. nuk rezulton të ketë të regjistruar procedime penale.

**5.4** Në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar për blerjen e automjetit, Komisioni konstaton se personi fizik ka filluar aktivitetin më 12.2.2013 dhe ka rezultuar me fitim në shumën 7,084,434

<sup>60</sup> Kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 29.11.2016.

<sup>61</sup> Pagesa është kryer me faturën tatimore të shitjes nr. \*\*\*, datë 29.9.2016.

<sup>62</sup> Vlera e deklaruar 3,598 euro vjen si rezultat i përfitimit të noterit nga kryerja e transaksionit të shitjes pranë zyrës së saj, ku sipas udhëzimit nr. \*\*\*, datë 14.6.2012, përcaktohet se për transaksione me vlerë mbi 5,000,001 lekë tarifa është 0.23% e vlerës së kontratës.

<sup>63</sup> Përgjigje nr. \*\*\*, datë 9.1.2023, e “Raiffeisen Bank”.

<sup>64</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 17.7.2020.

<sup>65</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2022, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

lekë për vitin 2013, shumë kjo e mjaftueshme për të përballuar çmimin e blerjes prej 1,200 euro dhe pagesën e doganës 54,400 lekë.

**Personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.**

**6. Aktivitet privat “noteri” me NIPT \*\*\*.** Personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhurat neto të përfituara nga ky aktivitet, si vijon: për periudhën mars - dhjetor 2013 të ardhurat neto 7,871,647 lekë; për periudhën janar - dhjetor 2014 të ardhurat neto 4,707,875 lekë; për periudhën janar - dhjetor 2015 të ardhurat neto 8,778,539 lekë; për periudhën janar - dhjetor 2016 të ardhurat neto 7,362,855 lekë.

**6.1** Në DIPP-të periodike subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i bashkëshortes si notere, të ardhura neto si vijon: viti 2013 = 7,084,507 lekë; viti 2014 = 1,187,728 lekë; viti 2015 = 1,320,664 lekë; viti 2016 = 7,359,882 lekë.

**6.2** Subjekti së bashku me deklaratën *Vetting* ka depozituar ekstraktin e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (në vijim QKB), e cila konfirmon regjistrimin e shtetases E. N. si person fizik, notere, me NIPT \*\*\*, në datën 12.2.2013. Janë depozituar gjithashtu edhe pasqyrat financiare të aktivitetit tregtar të “noterisë” për periudhën 2013 – 2016. Pasqyrat financiare janë depozituar edhe me pyetësorin standard.

**6.3** QKB-ja<sup>66</sup> konfirmon regjistrimin e shtetases E. N. si person fizik, me aktivitet “notere”, me NIPT \*\*\*, me datë 12.2.2013.

**6.4** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT)<sup>67</sup> konfirmon regjistrimin e shtetases E. N. si administratore e personit fizik me status aktiv që në datën 12.2.2013. Kjo drejtori ka depozituar dokumentacionin me informacionin e pasqyruar në sistemin C@TS në lidhje me të ardhurat bruto dhe neto nga aktiviteti si notere<sup>68</sup>.

**6.5** Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë jo të saktë të ardhurat nga aktiviteti i noterisë në deklaratën *Vetting*, pasi herë i është referuar fitimit neto (viti 2016), herë fitimit bruto (vitet 2013 dhe 2015). Gjithashtu, në deklaratimet periodike për vitet 2014 - 2015 subjekti ka deklaruar tatimin mbi fitimin dhe jo fitimin e realizuar (si bruto apo neto).

**6.6** Komisioni vëren se dokumentacioni i depozituar nga DPT-ja dhe ai i administruar nga faqja zyrtare e QKB-së janë të njëjta me ato të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësorë. Komisioni, referuar këtij dokumentacioni, mori në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij si të ardhura nga aktiviteti privat i noterisë për vitet 2013 – 2016, fitimin neto të realizuar sipas deklaratave të mësipërme, si dhe likuiditetet (në arkë dhe bankë) e personit fizik të pasqyruara në këto dokumente.

<sup>66</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2021, e QKB-së.

<sup>67</sup> Përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPT-së.

<sup>68</sup> Viti 2013 = të ardhurat bruto 7,871,674 lekë, tatimi i paguar = 787,167 lekë, të ardhurat neto = 7,084,507 lekë; viti 2014 = të ardhurat bruto 7,570,774 lekë, tatimi i paguar = 1,024,701 lekë, të ardhurat neto = 6,546,073 lekë; viti 2015 = të ardhurat bruto 8,778,539 lekë, tatimi i paguar = 1,320,678 lekë, të ardhurat neto = 7,457,861 lekë; viti 2016 = të ardhurat bruto 8,658,685 lekë, tatimi i paguar = 1,298,803 lekë, të ardhurat neto = 7,359,882 lekë.



**6.7** Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka konstatuar se personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja E. N., nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP të ardhurat nga aktiviteti privat i noterisë dhe për këtë qëllim i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.8** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se konstatimi i Komisionit është i drejtë, por kjo ka ndodhur për shkak të gabimeve dhe mosnjohja e saktë e të dhënave financiare që duheshin dërguar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, por këto pasqyra financiare janë dërguar vit pas viti në institucionet kompetente.

#### **Vlerësimi i çështjes nga Komisioni**

**6.9** Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëshortja e tij, ka kryer deklaram të pasaktë të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria si person fizik, por pavarësisht kësaj, duke marrë në konsideratë faktin se dokumentacioni i depozituar nga subjekti është i njëjtë me atë të vënë në dispozicion nga institucionet e ngarkuara me ligj, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me këtë kriter.

### **7. Analiza financiare për vitet 2008 – 2016**

**8.1** Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë: (a) në shumën -97,927 lekë për periudhën para fillimit të detyrës; dhe (b) në shumën -4,093,296 lekë për periudhën në detyrë, 28.7.2008 – 2016<sup>69</sup>.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.2** Në shpjegimet e tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Për të gjitha shpjegimet, provat shkresore dhe argumentet jo vetëm të sipërcituara, por njëkohësisht edhe të dërguara kohë më parë pranë Komisionit, jam i mendimit dhe kam bindjen e plotë se së bashku me bashkëshorten kemi pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, qoftë për shumën -97,927 lekë, për periudhën para fillimit të detyrës si prokuror, ashtu edhe për shumën -4,093,296 lekë për periudhën në detyrën e prokurorit, veçanërisht për periudhën prej vitit 2013 e në vazhdim, ku të ardhurat financiare të përfituara nga burime të ligjshme janë në vlera të larta, si rrjedhojë e aktivitetit nga veprimtaria e biznesit (ushtrimi i veprimtarisë së noterisë) nga ana e bashkëshortes, fakt ky i pasqyruar dhe i dokumentuar dukshëm dhe mjaftueshëm, pikërisht nga të gjitha pasqyrat financiare të viteve 2013 – 2016<sup>70</sup>.*

*Njëkohësisht, në argumentet e mia doja të sillja në vëmendje të Komisionit se disponimi i shumave financiare të përfituara nga ana ime në mënyrë krejtësisht ligjore nga viti 1999 (është marrë ky vit*

<sup>69</sup> Shihni analizën financiare tek rezultatet e hetimit administrativ.

<sup>70</sup> Shihni shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit.

si pasojë e një përfitimi financiar prej 300,000 lekësh nga shitja e një banese) dhe në vazhdim deri në muajin korrik të vitit 2008 si para fillimit të detyrës, ashtu edhe pas fillimit të saj, ashtu siç kam deklaruar dhe provuar me dokumentacionin përkatës, i depozituar pranë Komisionit, pavarësisht mosdeklarimit të të ardhurave financiare vjetore për arsytet dhe shkaqet e sipërcituara, kam mendimin se nuk përbën shkelje të asaj natyre, për të cilat Komisioni është shprehur për mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve, kjo referuar dhe bazuar edhe në vendimin nr. 29, datë 21.7.2022, të Kolegjit ku, ndër të tjera, në pikat 26 dhe 27 theksohet: '26. Nga verifikimi në vijim i deklarimeve pranë ILDKPKI-së, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se shumatat e disbursuara nga kredia i ka tërhequr dhe i ka mbajtur si para cash në banesë në vitet 2007 dhe 2008. Edhe në deklaratën e vitit 2009, në deklarimin e marrëdhënies së krijuar me shoqërinë '{\*\*\*}' sh.p.k., me rastin e lidhjes së kontratës së porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 9.10.2009, për apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit për likuidimin e këstit të parë prej 72.000 euro. Në këto kushte, konstatimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratat e pasurisë së viteve 2007 dhe 2008, për shkak të mosdeklarimit të disponimit cash të shumës prej 5.000.000 lekësh, të tërhequr nga disbursimi i kredisë, është një konstatim i drejtë, pasi mënyra e deklarimit të subjektit nuk përputhet me parashikimin e nenit 4, germa 'd' e ligjit nr. 84/2016. 27. Trupi gjykues mori në analizë çështjen nëse pasaktësia për shkak të mosdeklarimit në deklaratat periodike, si gjendje cash e shumës së marrë nga kredia, afekton deklarimin e subjektit në deklarimin e pasurisë së rivlerësimit, duke e bërë atë, përveçse të pasaktë, edhe të pamjaftueshëm, referuar situatës faktike të rezultuar nga tërësia e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer në Komision, e të pasqyruar në paragrafin 23, më sipër në këtë vendim. Trupi gjykues konstatoi se mosdeklarimi i këtij fakti juridik nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike nuk pamundësoi institucionet e rivlerësimit për kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të tij në deklaratën e rivlerësimit lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ekzistencën e kredisë dhe qëllimin e marrjes së saj, në mënyrë konstante, në çdo deklarim periodik, kredi e cila ka shërbyer për blerjen e pasurisë së vetme të subjektit të rivlerësimit, në përputhje të plotë me qëllimin dhe objektin e kredisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi çmoi të rritshëm vlerën që kanë deklaratat e mëparshme të subjekteve të rivlerësimit, në vijim edhe të asaj që është theksuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, arriti në konkluzionin se pasaktësia e deklarimeve periodike, në rastin konkret, nuk përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, deklaruar saktë e plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës mosdeklarimi i posedimit cash të shumës prej 5,000,000 lekësh në vitet 2007 dhe 2008 dhe përdorimi i saj në vitin 2009, të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi, për deklarimin e pasurive. Gjithashtu, nga hetimi administrativ nuk rezultoi e provuar që me këtë veprim (mosdeklarimin në deklaratat e viteve 2007 dhe 2008 të disponimit cash të të ardhurës nga kredia), subjekti i rivlerësimit të ketë pasur si qëllim të mbajë jashtë vëmendjes dhe kontrollit të organit kompetent (ILDKPKI) këto pasuri të luajtshme dhe veprimet lidhur me to në formën e deklarimit të rremë. Mosdeklarimi i gjendjes së këtyre

*parave si gjendje cash në vitet 2007 dhe 2008, sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, ka ardhur pikërisht si pasojë e perceptimit të tij se duke deklaruar kredinë dhe destinacionin e saj kishte përmbushur detyrimin për deklarim. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit duken bindëse, në kushtet kur këto likuiditete, të cilat nuk janë krijuar nga kursime të saj, por burojnë nga një marrëdhënie e ligjshme kredie, në fakt nuk kanë pësuar shtim apo pakësim në momentin e disponimit cash, por vetëm kanë ndryshuar vendin e ruajtjes së tyre, nga banka në banesë. Trupi gjykues vlerësoi se nuk mund të lihet pa vënë re edhe fakti se nga autoritetet ndihmëse për kontrollin e kriterit të figurës nuk është raportuar asnjë dyshim apo indicie për përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, të cilat mund të shërbenin për të lëkundur bindjen se subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar gjendjen cash në banesë të shumës 5,000,000 lekë, të rrjedhur nga kredia, do ta kishte shpenzuar atë dhe, për pasojë, pagesa e këstit të parë prej 72,000 euro do të buronte nga burime të paignifikuara”*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**8.3** Komisioni, pasi mori në konsideratë provat e siguruara përgjatë hetimit nga institucione të ndryshme të së drejtës publike e private, individë, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se balanca financiare përpara fillimit të detyrës në shumën -97,927 lekë ndryshon në balancë pozitive për shkak të përfshirjes së shumës 300,000 lekë, të përfituar nga subjekti si rrjedhojë e shitjes së apartamentit në bashkëpronësi me prindërit dhe dy vëllezërit në vitin 1999, e konfirmuar kjo me kontratën përkatëse të shitblerjes, si dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.12.2022, të babait të subjektit, shtetasit F. N..

**8.4** Në lidhje me balancën negative gjatë ushtrimit të detyrës, Komisioni i vlerëson të mjaftueshme dhe bindëse provat dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2002 prej 1,000,000 lekësh kanë shërbyer për çeljen e depozitës në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 4.9.2008, depozitë e cila më 31.1.2013 ka shërbyer si një nga burimet për blerjen e njësisë me sip. 40 m<sup>2</sup>. Marrja në konsideratë e kësaj shume e kalon në balancë financiare pozitive rezultatin financiar negativ të vitit 2008 prej -809,262 lekësh.

**8.5** Në lidhje me balancën financiare të mbetur të vitit 2012, që afektohet pikërisht vetëm nga blerja e automjetit tip “Toyota RAV4” në vitin 2012, për shumën 24,200 euro dhe pagesën e taksës doganore prej 701,022 lekësh, Komisioni mban në konsideratë të gjitha argumentet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi dhe, duke qenë se:

- kjo është e vetmja pasuri që afektohet nga një lloj problematike që konsiderohet e pranueshme nga Komisioni;
- subjekti i rivlerësimit është konsideruar i përshtatshëm<sup>71</sup> si nga Grupi i Punës pranë DSIK-së, ashtu edhe pas hetimit të kryer nga Komisioni, çka do të thotë se nuk rezulton të ketë asnjë *indicie*, informacion nga burime të kategorizuara ose jo apo gjurmë përfitimesh të paligjshme/korrupsioni nga subjekti i rivlerësimit, çka do të ngrinte qoftë edhe dyshimin më të vogël tek Komisioni se ky automjet është blerë me të ardhura jo të ligjshme;

---

<sup>71</sup> Shihni pikën B të vendimit.

- subjekti i rivlerësimit ka marrë një vlerësim pozitiv në lidhje me kriterin e aftësive profesionale<sup>72</sup> si nga Grupi i Punës pranë KLP-së, ashtu edhe nga vetë Komisioni ku, përveç kësaj, shtuar edhe faktin se përgjatë një karriere profesionale prej 15 vitesh në detyrën e prokurorit, në adresë të subjektit kanë ardhur vetëm dy denoncime, të cilat u vlerësuan pa probleme nga Komisioni, çka do të thotë se nuk ka asnjë gjurmë apo *indicie* përfitimesh të paligjshme nga subjekti si rezultat i veprimtarisë së tij profesionale apo edhe jashtë saj,
- Komisioni arrin në konkluzionin se balanca financiare negative e mbetur pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, në shumën -1,136,829 lekë, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerësohet se nuk arrin deri në atë nivel saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e pasurisë.

## B. KONTROLI I FIGURËS

8. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2022, ka përcjellë pranë Komisionit raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani, i deklasifikuar plotësisht (me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2022, të KDZH-së) dhe nga Grupi i Punës informohet se:

- i) Formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
- ii) Për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Sokol Nishani.*

**Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë konfirmon përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani.**

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

9. Rivlerësimi profesional sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është i bazuar në raportin e përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional dhe kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ky organ ka hartuar raportin vlerësues nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani.

---

<sup>72</sup> Shihni pikën C të vendimit.

**9.1 Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:** (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja; (ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; dhe (iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

**9.2** Në raportin e Komisionit të Vlerësimit pranë KLP-së për subjektin e rivlerësimit janë evidentuar aftësi të mira profesionale, aftësi të mira organizative, etike dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe aftësi personale dhe angazhim profesional.

**9.3 Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit** – nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Rubrikat janë plotësuar me saktësi.

#### **9.4 Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti “Vendim për pezullimin e procedimit penal nr. \*\*\*73”**, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës – subjekti i rivlerësimit, pasi ka analizuar të gjithë veprimtarinë hetimore, ka konkluduar se nuk është bërë e mundur gjetja e autorit/autorëve, duke çmuar se nuk ka veprime të mëtejshme hetimore për të kryer për zbulimin e autorëve të saj dhe bazuar në nenin 326/1 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur: *“Pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. \*\*\* për veprat penale ‘vrasje me paramendim’ e kryer në bashkëpunim dhe ‘prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake’, e parashikuar nga nenet 78 - 25 e 278/5 të Kodit Penal”*. Vendimi është i arsyetuar dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm, janë pasqyruar të gjitha veprimet procedurale dhe baza ligjore është identifikuar e drejtë.

**Dokumenti “Urdhër për regjistrimin e procedimit penal të vitit 2016<sup>74</sup>”** – mbështetur në aktet hetimore të realizuara deri në ato momente në mbështetje të neneve 24/1/3, 287 dhe 315/3 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar urdhrin për regjistrimin e procedimit penal. Në këtë akt prokurori ka urdhëruar që në kolonën përkatëse të shënohej emri i personit që i atribuohet vepra penale, konkretisht “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal.

**Dokumenti “Konkluzione përfundimtare për procedimin penal nr. \*\*\*75”** – subjekti, në konkluzionet e tij, evidenton se nga pyetja e dëshmitarëve okularë të kësaj ngjarjeje të rëndë kriminale ka rezultuar e provuar dhe dokumentuar se autori i vrasjes së A. B. dhe plagosjes së F. B. dhe V. B. është i pandehuri B. B., i cili është edhe ekzekutori në këtë ngjarje dhe në bashkëpunim me babain e tij, i cili ishte në rolin e nxitësit, kanë kryer veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”. Pas deklarimit të mbyllur të hetimit gjyqësor, prokurori Sokol Nishani ka paraqitur konkluzionet përfundimtare, ku ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit B. B. dhe dënimin e

<sup>73</sup> Ky procedim i referohet ngjarjes së ndodhur në datën 8.6.2015, ku në një lokal në qytetin e Durrësit nga persona të paidentifikuar u qëllua me armë zjarri dhe mbeti i vranë në vend shtetasi R. R., i cili ishte edhe në kërkim nga policia.

<sup>74</sup> Ky procedim i referohet ngjarjes së datës 26.11.2016, ku shtetasi S. M., teksa drejtonte automjetin e tij përgjatë segmentit rrugor \*\*\* , ka aksidentuar duke i shkaktuar dëmtime të rënda një shtetasi.

<sup>75</sup> Ky procedim i referohet ngjarjes së ndodhur në datën 11.10.2013, ku si pasojë e një konflikti të ndodhur aty midis dy familjeve, i pandehuri B. B., duke qenë se ka shkuar i armatosur ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të shtetasit V. B., të cilin nuk e kapin plumbat dhe me paramendim qëllim mbi shtetasin A. B., i cili nga plagët e marra gjeti vdekjen e menjëhershme, më pas i pandehuri B. B. ka qëlluar me të njëjtën armë shtetasin F. B., më pas qëllon A. B. dhe F. B. dhe nënën e tyre V. B.

tij për veprën penale përkatëse<sup>76</sup>. Përmbajtja e dokumentit të njeh me objektin e veprës penale, rrethanat e ngjarjes dhe tablonë e veprimtarisë hetimore. Subjekti i rivlerësimit parashtron hollësisht provat në funksion të vërtetimit të akuzës. Në aktin e diskutimit përfundimtar janë respektuar kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij.

**Komisioni vëren se pas analizimit të dokumentacionit në 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse edhe nga ana e KLP-së, nuk janë konstatuar problematika në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.**

**Dosja 1** – “Vendim për mosfillimin e procedimit penal të vitit 2013<sup>77</sup>”, që i referohet kallëzimit nr. \*\*\*. Sipas shpjegimeve të kallëzuesit, kërcënimi nuk është shoqëruar me asnjë veprim konkret në drejtim të përdorimit të dhunës fizike apo psikike apo edhe me ndonjë mjet të kundërligjshëm dhe të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e personit. Pas administrimit të materialit kallëzues sa më sipër, prokurori ka vlerësuar se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit dhe duke u bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “Mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. \*\*\*, viti 2013”. Nga përmbajtja e dokumentit, teksti është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është identifikuar drejt. Në vendim prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Nuk rezulton se ndaj këtij vendim të jetë bërë ankim nga palët.

**Dosja 2** – “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*<sup>78</sup>”. Nga veprimet hetimore të realizuara në funksion të procedimit penal ka rezultuar e provuar se autor i veprës penale, për të cilën u regjistrua procedimi penal, ishte shtetasi F. G., i cili pas një konflikti të çastit ka goditur me mjete të forta shtetasit A. B. dhe F. B., duke u shkaktuar dëmtime të shëndetit. Ankuesit, në cilësinë e personit të dëmtuar, pasi janë paraqitur vullnetarisht përpara OPGJ-së me vullnetin e tyre të lirë kanë deklaruar se tërheqin ankimin e bërë për ngjarjen e lartpërmendur dhe pasojën e ardhur prej saj në ngarkim të shtetasit F. G., duke kërkuar edhe pushimin e ndjekjes penale ndaj këtij të fundit për veprën penale “plagosje e lehtë” me dashje. Prokurori Sokol Nishani, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin të plota, ka konkluduar se neni 284 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se për veprën penale “plagosje e lehtë” me dashje, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të

---

<sup>76</sup> 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. B. për veprën penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese” ndaj dy ose më shumë personave, mbetur në tentativë duke shkaktuar vrasjen e shtetasit A. B., plagosjen e rëndë të shtetasit F. B. dhe plagosjen e lehtë të shtetasit V. B., në bashkëpunim me të pandehurin Gj. B. të parashikuara nga nenet 79/dh - 22 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm. 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit B. B. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” të parashikuar nga neni 278/4 (i pandryshuar) i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim. 3. Në aplikim të nenit 56 të Kodit Penal bashkimin e këtyre dënimeve duke e dënuar përfundimisht të pandehurin B. B. me burgim të përjetshëm.

<sup>77</sup> Ky kallëzim i referohet ngjarjes së datës 8.9.2013, ku shtetasi B. S. ka kallëzuar në Komisarriatën e Policisë \*\*\* se pas një debati me shtetasin A. H. për një mosmarrëveshje në lidhje me pronësinë e një apartamenti ky i fundit e ka kërcënuar.

<sup>78</sup> Ky procedim i referohet ngjarjes së datës 8.1.2014, ku shtetasi e dëmtuar A. B. dhe F. B. kanë kallëzuar shtetasin F. G., ku pas një grindjeje të çastit për motive të dobëta i ka goditur me mjete të forta, duke i shkaktuar dëmtime shëndetësore që, sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor janë klasifikuar si dëmtime të cilat kanë shkaktuar paaftësi të përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë.

procedimit. Nga përmbajtja e dokumentit, teksti përmban faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Baza ligjore e vendimit të mosfillimit të procedimit penal është identifikuar drejt. Nuk rezulton se ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim nga palët.

**Dosja 3** – “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*”. Ky procedim i referohet ngjarjes së datës 7.7.2015, ku në vendin e quajtur Shkëmbi i \*\*\* dy grupe personash, pjesëtarë të familjes B., kanë qenë në ambientet e lokalit në pronësi të familjes D., ku kanë shkaktuar dëme si pasojë e konsumit të alkoolit dhe janë përfshirë fillimisht në debate dhe, më tej, ka pasur të shtëna me armë zjarri, por pa pasoja për shëndetin e palëve në konflikt. Gjatë konfliktit shtetasi A. B. i familjes B. ka marrë një armë zjarri pistoletë të kalibrit 9 mm dhe ka qëlluar disa herë në ajër. Në funksion të hetimit është realizuar ekspertimi teknik i armës, nga ku është konkluduar se arma e tipit pistoletë e kalibrit 9 mm nuk klasifikohet në kategorinë e armëve luftarake, sportive apo standarde, por ajo klasifikohet në kategorinë e armëve speciale për imitimin e të shtënës së armëve të zjarrit apo të efekteve të tjera në varësi të përbërjes së fishekëve. Ndërsa 3 fishekët objekt ekspertimi nuk futen në kategorinë e municioneve luftarake, por në kategorinë e fishekëve specialë të kalibrit 9 mm, të cilët përdoren për imitim zhurmash. Prokurori Sokol Nishani, në çmim të të dhënave të grumbulluara nga hetimet e kryera bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi A. B. është marrë i pandehur për veprën penale “prishje e qetësisë publike”, parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal. Në konkluzionet përpara gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit A. B. dhe dënimin e tij<sup>79</sup>. Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua.

**Dosja 4** – “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*” për veprën penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Ky procedim i referohet ngjarjes së datës 7.8.2015, ku në rrugën Durrës-Plazh shërbimet e policisë kanë ndaluar për kontroll mjetin me targa \*\*\*, me drejtues shtetasin K. B., i cili ka deklaruar se ishte i papajisur me leje drejtimi. Në këto rrethana është bërë arrestimi në flagrancë i tij. Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” të shtetasit K. B., i cili është marrë i pandehur për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Prokurori, veç kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, i është drejtuar gjykatës edhe me atë për të proceduar me gjykim të njëkohshëm të themelit të kësaj çështjeje, kjo pasi hetimet ishin të plota dhe i pandehuri është arrestuar menjëherë pas kryerjes së veprës penale me sende dhe prova nga të cilat duket se e ka kryer atë. Në mbështetje të neneve 400, 401, 228, 229, 244, 251, 258, 259 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar kërkesën për vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit, si dhe atë të gjykimit të çështjes ndaj të pandehurit K. B. Dokumenti “Kërkesë” përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Penale. Në konkluzionet përfundimtare drejtuar

---

<sup>79</sup> “Deklarimin fajtor të pandehurit A. B. për veprën penale ‘prishje e qetësisë publike’, të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen e dënimin me 1/3 e tij”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2016, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të pandehurit A. B. për veprën penale ‘prishje e qetësisë publike’, të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht të tij me 3 muaj e 10 ditë burgim”.

gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij<sup>80</sup>. Vendimi mori formë të prerë pa u ankimuar.

**Dosja 5** – “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*” për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/2/3 i Kodit Penal në ngarkim të të pandehurit A. P.

Ky procedim i referohet faktit kriminal të konstatuar dhe dokumentuar në datën 12.4.2013, ku në ambientet e brendshme të një kompleksi blegtoral në pronësi të shtetasve R. T. dhe I. M., pas njoftimit të marrë, shërbimet e policisë kanë gjetur dhe sekuestruar disa armë automatike dhe fishekë luftarakë, të cilat mbaheshin pa lejen e organeve kompetente. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se këto armë janë fshehur në ambientet e kompleksit blegtoral nga i pandehuri A. P. pa dijeninë e pronarëve R. T. dhe I. M., ku sipas deklarimeve të shtetasit A. P. ai i kishte marrë në një vend të fshehur, pasi i kishte lënë aty një person i pidentifikuar. Prokurori Sokol Nishani, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi A. P. është marrë i pandehur për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2/3 i Kodit Penal. Dokumenti “kërkesë” përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga Kodi i Procedurës Penale. Në konkluzionet përfundimtare drejtuar gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar deklarinin fajtor të të pandehurit A. P. dhe dënimin e tij<sup>81</sup>.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.5.2015, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit burg dhe deklarinin fajtor të të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve dënimin përfundimtar të të pandehurit A. P. me 4 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimisht me 2 vjet e 8 muaj burgim”*. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.1.2016, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin A. P. me 2 vjet e 3 muaj burgim.

---

<sup>80</sup> “Deklarimin fajtor të të pandehurit K. B. për kryerjen e veprës penale ‘drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt’, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 ditë burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen e këtij dënimi me 1/3 e tij”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 10.8.2015, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit K. B. për kryerjen e veprës penale ‘drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt’, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 ditë burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen e këtij dënimi me 1/3 duke e dënuar përfundimisht të pandehurin K. B. me 10 ditë burgim”*.

<sup>81</sup> Deklarimin fajtor të të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 vit e 3 muaj burgim dhe deklarinin fajtor të të pandehurit A. P. për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dhe dënimin përfundimtar të të pandehurit A. P. me 1 vit e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale uljen e këtij dënimi me 1/3 e tij.



**Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit në 5 dosjet e përzgjedhura me short, ashtu sikurse edhe KLP-ja, nuk ka konstatuar problematika në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.**

## **9.5 Të dhëna arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime**

i) Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se prokurori Sokol Nishani nuk ka pasur masa disiplinore apo ankesa. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.

ii) Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim PPKKKO)<sup>82</sup> bën me dije se ndaj shtetasit Sokol Nishani nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal. Nga verifikimi i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda rezulton se ndaj këtij shtetasi janë përcjellë dy materiale kallëzuese, për të cilat është vendosur mosfillimi si procedim penal<sup>83</sup>.

iii) Me vendim të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit Sokol Nishani, për vitet 2012 dhe 2016 është vlerësuar “shumë mirë”, ndërsa për vitin 2013 është vlerësuar “mirë”.

## **9.6 Të dhëna nga prokuroritë**

a) **Prokuroria e Përgjithshme**<sup>84</sup>, me shkresën e datës 6.4.2021, ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacionin nga të gjitha prokuroritë.

b) **Prokuroritë e rretheve gjyqësore**<sup>85</sup> kanë konfirmuar se pranë tyre nuk rezulton të jenë depozituar kallëzime apo procedime në ngarkim të subjektit Sokol Nishani.

<sup>82</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2021.

<sup>83</sup> 1. PPKKKO-ja, në datën 19.11.2018, ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, në bazë të kallëzimit të shtetasit M. R., i cili parashtron se në datën 11.8.2018, si pasojë e një aksidenti automobilistik ka pësuar dëmtime babai i tij. Kallëzuesi pretendon se si pasojë e hetimeve në kundërshtim me ligjin, si dhe ndikimit të paligjshëm, prokurori Sokol Nishani ka kërkuar para gjykatës caktimin e një mase të lehtë sigurimi për drejtuesin e automjetit duke e zhveshur atë nga përgjegjësia penale dhe duke bërë fajtor këmbësorin babain e tij. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave ka konkluduar se në pretendimet e parashtruara nga kallëzuesi nuk evidentohet asnjë *indicie*, fakt apo provë që mund të përbëjë dyshim të arsyeshëm mbi ekzistencën e elementeve të veprës penale të parashkuar nga neni 248 apo ndonjë veprë tjetër penale. Në mbështetje të nenit 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur mosfillimin si procedim penal të kallëzimit të bërë nga shtetasi M. R.

2. PPKKKO-ja ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2015, në bazë të kallëzimit të shtetasit A. P. Shtetasi në kallëzim pretendon se nga ana e disa prokurorëve (ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit) është konsumuar vepra penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të fushës së drejtësisë”. Konkretisht, sa i përket prokurorit Sokol Nishani, shtetasi A. P. pretendon se është arrestuar në kundërshtim me ligjin, pasi nuk kishte kryer asnjë veprë penale, por ky veprim është realizuar nga prokurori nën ndikimin politik. Kallëzuesi, gjithashtu, ka pretenduar se teksa qëndronte në paraburgim një person i ka ofruar si mundësi lirimi pagesën e një shume prej 10,000 euro, të cilat do t’i përfitonin prokurorët e çështjes. I pyetur për rrethanat e kallëzimit, ky shtetas ka shpjeguar se këtë shumë ai nuk e ka dhënë pasi nuk ka pasur mundësi financiare, gjithashtu ka konfirmuar se në asnjë rast nuk ka pasur kontakte me prokurorët e çështjes. Nga verifikimet e realizuara në funksion të kallëzimit rezultoi se shtetasi A. P. ishte dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale “mashttrim”. Në funksion të këtij kallëzimi prokurori ka kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave ka konkluduar se në pretendimet e parashtruara nga kallëzuesi nuk evidentohet asnjë *indicie*, fakt apo provë që të përmbajë elementet e ndonjë veprë penale. Në mbështetje të nenit 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, në datën 9.2.2016 prokurori ka vendosur mosfillimin si procedim penal të kallëzimit nr. \*\*\*.

<sup>84</sup> Prokuroria e Përgjithshme, me nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021.

<sup>85</sup> Prokuroritë e rretheve gjyqësore: Krujë, me nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; Kavajë, me nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021; Pukë, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Berat, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Mat, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Kurbin, me nr. \*\*\*prot.,

## DENONCIME/ANKESA NGA PUBLIKU

**10.** Për subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani janë depozituar 3 dokumente nga publiku.

**11.1 Dokumenti “vlerësim për hetim me profesionalizëm dhe ndershmëri të çështjes nga prokurori Sokol Nishani”, me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2020,** i 3 shtetasve polakë, të cilët shprehin vlerësimet maksimale të tyre për punën profesionale të prokurorit Sokol Nishani për një çështje të hetuar prej tij, ku këta shtetas ishin në rolin e të dëmtuarve.

**11.2 Dokumenti “ankesë” nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2019, i shtetasit A. L.,** i cili ngre pretendime për disa gjyqtarë dhe prokurorë që kanë vepruar në mënyrë të paligjshme, duke e dënuar atë me 2 vjet burgim. Denoncuesi përmend në këtë ankesë edhe subjektin e rivlerësimit Sokol Nishani që kishte lidhje me një person tjetër, por që nuk ishte prokurori që kishte hetuar çështjen e tij në shkallë të parë apo edhe në apel.

**Komisioni vëren se denoncimi nuk plotëson kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi denoncuesi nuk ka referuar rrethana konkrete, praktika apo veprime specifike që të krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.**

### **11.3 Në lidhje me denoncimin e shtetasit I. H.**

Shtetasi I. H., në datën 11.4.2023, 3 ditë përpara seancës dëgjimore që i ishte caktuar subjektit në datën 14.4.2013, ka depozituar pranë Komisionit një denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit Sokol Nishani, ku pretendonte se ky i fundit po zvarriste hetimet ndaj një kallëzimi të bërë nga ky shtetas.

Komisioni, në datën 12.4.2023, me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit për këtë denoncim dhe për pretendimet e denoncuesit i kërkoi subjektit të japë shpjegime deri ditën e seancës dëgjimore.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.4.2023, dërgoi pranë Komisionit shpjegimet në lidhje me denoncimin e shtetasit I. H.. Subjekti ka shpjeguar se në datën 10.11.2022 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin nr. \*\*\*, për veprën penale “falsifikim kompjuterik”, i parashikuar nga neni 186/a i Kodit Penal, veprë e cila iu ngarkua OPGJ-së për veprime të mëtejshme. Nga materiali i kallëzimit rezulton se sipas deklaramentit të tij shtetasi I. H. deklaroi se në rrjetet sociale janë hapur profile false të tij dhe dyshon se këtë gjë ia ka bërë shtetasi E. R. Sipas subjektit hetimet për këtë procedim vazhdojnë për dy arsye objektive:

*Së pari*, ngarkesa e përditshme në punë si prokuror, por dhe e OPGJ-së, është mjaft e madhe dhe me një dinamikë të jashtëzakonshme dhe, *së dyti*, vetë natyra e hetimit dhe dokumentimit të kësaj vepre penale kërkon kohë, por edhe njohuri të posaçme nga një specialist i fushës së informatikës dhe kompjuterike për të arritur një përfundim sa më të drejtë e mbi të gjitha ligjor dhe profesional. Subjekti thekson faktin se shtetasi I. H. gjatë vitit 2022 ka depozituar pranë kësaj prokurorie mjaft

---

datë 18.2.2021; Tropojë, me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Përmet, me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Gjirokastrë, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Kukës, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Fier, me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Sarandë, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Korçë, me nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Shkodër, me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Pogradec, me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Dibër, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Lezhë, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Lushnjë, me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Vlorë, me nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Elbasan, me nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021; Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Durrës, me nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021.

kallëzime për persona të ndryshëm, ku një pjesë e tyre janë regjistruar, të cilat janë në hetim nga prokurorë të tjerë. Thekson se nga ana e tij si prokuror nuk ka pasur zvarritje hetimi të këtij procedimi penal dhe se ankimi i tij është depozituar përpara seancës dëgjimore të caktuar ndaj personit të tij në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Subjekti ka depozituar disa urdhra regjistrimi procedimi penal me kallëzues I. H., që po hetohen nga prokurorë të tjerë.

Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me pretendimin për zvarritje procesi. Ai ka shpjeguar se ka filluar veprimet hetimore ndaj kallëzimit të bërë nga ky shtetas dhe për këtë qëllim ka vijuar caktimin e veprimeve hetimore që do të kryhen nga ana e OPGJ-së. Nisur nga vetë natyra e veprës penale “falsifikim kompjuterik”, është vepër e cila kërkon hetime të thelluara të bazuara në njohuri specifike nga specialistë të fushës, nga e cila kërkon edhe kohën e duhur. Bazuar edhe nga moria e kallëzimeve që ky shtetas ka depozituar në vitin 2022 pranë kësaj prokurorie, pretendimi i tij për zvarritje nuk është bazuar në *indicie* konkrete.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Sokol Nishani:

**i)** Ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi e karakterit minimal, të cilat konsiderohen si pasaktësi që nuk kanë pasur për qëllim fshehje pasurie apo deklarin të rremë.

**i/1)** Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshortja kanë pasur mungesë burimesh financiare në vitin 2012 në shumën - 1,136,829 lekë, për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të deklaruara.

**i/2)** Komisioni, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerëson se pasaktësitë e konstatuara, si dhe mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për të justifikuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

**i/3)** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Sokol Nishani ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

ii) Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Sokol Nishani ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

iii) Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirëkualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Sokol Nishani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 19.4.2023.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Relator

**Xhensila PINE**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Suana Stafa*